

# **RAPORT**

## **I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

### **Për Programin e studimit Master i Shkencave**

#### **në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile:**


- a) *"Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"*
- b) *"Menaxhim i Ndërtimeve"*
- c) *"Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit"*
- d) *"Inxhinieri e Resurseve Ujore"*

#### **ofruar nga Universiteti EPOKA**

Ekspertet e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Ass. Dr. Florim GRAJÇEVCI

Dr. Egla LUCA



Egla Luca

Janar /2019


## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile:**

- Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit;
- Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit
- Menaxhim i Ndërtimeve
- Inxhinieri e Resurseve Ujore

<b>Tabela e të dhënave për programin e studimit</b>		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "Epoka"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 90, datë 10.02.2010, vetëm për profilet: a) Inxhinieri e strukturave të ndërtimit; b) Menaxhim i ndërtimeve Leja për ushtrimin e veprimtarisë, UMASH Nr. 379, datë 19.07.2010 Shkresë e MASR Nr. 586/1 prot., datë 27.03.2018 konfirmohet miratimi i dy profileve të reja të këtij programi: c) Inxhinieri e Resurseve Ujore dhe d) Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit,
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër i MASH Nr. 286, datë 06.07.2012 VKA Nr. 339, datë 08.06.2012 (Akreditohen dy profilet, me rekomandime)
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi me profile: a) Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit; b) Menaxhim i Ndërtimeve; c) Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; d) Inxhinieri e Resurseve Ujore
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS për dy profile: a) dhe b) 121 ECTS për dy profile: c) dhe d)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhë Angleze
11	Programi ofrohet nga institucioni	Universiteti Epoka
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
13	Diplomë e përbashkët /Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2010 për dy profile/ 2018 për dy profile
16	Numri i studentëve	20 studentë (për dy vitet e fundit)

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL



## HYRJE

**Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile:**

- a) *Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit;*
- b) *Menaxhim i Ndërtimeve;*
- c) *Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit;*
- d) *Inxhinieri e Resurseve Ujore.*

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit; Menaxhim i Ndërtimeve; Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; dhe Inxhinieri e Resurseve Ujore i Universitetit "EPOKA" ofrohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, përkatësisht Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në gjuhën angleze.

Programi i Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" të ciklit të dytë, në formë të studimeve me kohë të plotë me profilet: Inxhinieri e strukturave të Ndërtimit; Menaxhimi i Ndërtimit, është licencuar me VKM Nr. 90, datë 10.02.2010 "Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së Lartë private "EPOKA".

Me Urdhër të MASH Nr 379, datë 19.07.2010 "Lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit, shkollës së lartë private "Epoka", është lejuar veprimtaria akademike në vitin akademik 2010-2011.

Ky program është akredituar për herë të parë me Urdhër i MASH Nr. 286, datë 06.07.2012, bazuar në VKA Nr. 339, datë 08.06.2012 (Akreditohen, me rekomandime dy profilet)

Universiteti "Epoka" ka paraqitur kërkesën për miratimin e riorganizimit të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, duke shtuar dy profile të reja: c) Inxhinieri e Resurseve Ujore dhe d) Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit. Ndryshimet profilizuese në fjalë janë miratuar me vendimin nr. 3 datë 10.12.2014 të Senatit Akademik dhe aprovuar me shkresën e MASR Nr. 586/1 prot., datë 27.03.2018.

Nga Takimet me drejtuesit e Njësive, u deklarua se këto dy profile u hapën për herë të parë në vitin akademik 2018-2019.

Objekt i këtij vlerësimi janë vitet akademike 2012-2019.

## GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Ass. Dr. Florim Grajçevci

Dr. Egla Luca

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL /Bordi i Akreditimit. Menaxherë teknikë (MT) të ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure janë specialistët e ASCAL, R. Qatipi dhe E. Xhako.

Më datë 05.11.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 125/9 Prot., datë 06.11.2018 "Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", Universiteti EPOKA është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.



Më datë 14.11.2018, Universiteti EPOKA përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 088/5 Prot., datë 12.11.2018 "Dërgohen komente në lidhje me draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Msc në "Inxhinieri Ndërtimi, me profile".

Në këtë dokument institucioni ka bërë disa komente për Draft-RVJ.

GVJ pasi u njoh me komentet e percjella nga institucioni, mendon se: Komentet e bëra për draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm nga Universiteti EPOKA, në përgjithësi janë lidhur me Rekomandimet e bëra në Raport. Rekomandimet në kuptimin e fjalës përmbushin funksionalitetin e Standardeve të përcaktuara nga ana e Agjencisë për sigurimin e cilësisë në Arsimin e Lartë dhe njëkohësisht përmirësojnë cilësinë e kurrikulës për të cilën kërkohet Riakreditimi.

#### **Përgjigje për Komentet e Universitetit EPOKA, lidhur me Rekomandimet në RVJ:**

**Komentet për rekomandimet 1, 2 dhe 3:** IAL i vlerëson rekomandimet e propozuara dhe për të njejtat IAL do të reflektoj.

**Komentet për Rekomandimin 4:** Rekomandimi i bërë për orët në auditor është me qëllimin më të mirë për Studentët, që ata të kenë mundësinë më të madhe të shfrytëzojnë asetet të cilat i ofron IAL, dhe ky rekomandim nuk duhet ndryshuar nga RVJ. GVJ nuk e mer në konsideratë komentin e GVB për shkak se edhe pse lëndët janë të bazuara në punë individuale, përsëri baza teorike duhet dhënë për të gjithë studentët. Nëse janë punë individuale atëherë këto orë duhen futur brënda orëve të punës individuale në kurrikul dhe të mos planifikohen dhe deklarohen si orë në auditor.

**Komentet për Rekomandimin 5:** Në matricën e shpërndarjes së lëndëve nga kurrikula e programit një rekomandim i tillë është i qëndrueshëm dhe nuk duhet të ndërrohet në RVJ, dhe se IAL duhet reflektuar sa më parë në kurrikulë lidhur me këtë rekomandim. GVJ nuk e mer në konsideratë komentin e GVB. Komenti është bërë për arsye se në dy profilet "Profili Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit dhe Profili Inxhinieri e Resurseve Ujore një nga lëndët me zgjedhje ka 7 kredite ndërkohë që është në kategorinë D të lëndëve të cilat kanë të gjitha 6 kredite. Gjithashtu për profilin Menaxhim i Ndërtimit si lëndë karakterizuese është "Fundamentals of Steel Design" ndërkohë që ne gjykojmë që kjo lëndë nuk është karakterizuese për profilin dhe mund të zëvendësohet nga një lëndë tjetër më specifike e profilit.

**Komentet për Rekomandimin 6:** Në të gjitha kurrikulat e programeve të studimeve përcaktohen lëndët me peshat e tyre, përkatësisht kreditë e tyre dhe se nga totali i kredive programi përcakton peshën e punimit të diplomës. Secila nga lëndët përkatësisht provimet janë të pjesshme në përmbushjen e tërësisë së kredive, sikur është dhe diploma e cila merr një sasi të kredive dhe është e pjesshme, prandaj rekomandimi për rishikimin e formatit të diplomës ka për qëllim që nga diplomat të largohet termi "*In partial fulfilment of the requirements for the degree of Master of Science in Civil Engineering*" sepse ekzistenca e kësaj fjalie në kapakun e diplomës zhvleftëson të gjithë punimin dhe ky rekomandim në RVJ duhet të qëndroj. Gjithashtu ky koment ka të bëjë edhe me mungesën e abstraktit në dy gjuhë.

**Komentet për Rekomandimin 7:** Punimi i diplomës përveç se është punë e pavarur hulumtuese pa dyshim është edhe përmbledhje e lëndëve në programin e studimeve. Duke gjykuar nga ky fakt atëherë rekomandimi i kontrollit të punimeve nga më së paku tre mësimdhënës është i bazuar në shtrirje të përgjegjësisë lidhur me problemet shkencore dhe garanton cilësi të punës.

**Komentet për Rekomandimin 8:** Rekomandimi i RVJ ka për qëllim që IAL të mos ketë gabime rastësore.

**Komentet për Rekomandimin 9 dhe 10:** Gjatë vizitës në IAL janë vërejtur mundësitë e shpërvjedhjes në transferim të studentëve nga MP në MSc, dhe IAL i rekomandohet që këtë praktikë të e minimizoj sa më shumë që mundet me qëllim ruajtjen e cilësisë së studimit.



*Përfundimisht, Rekomandimet e dhëna në RVJ edhe përkundër komenteve të dhëna nga IAL duhet të qëndrojnë dhe IAL duhet të Reflektojë sipas tyre.*

## **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË**

### **I. Rekomandimet e KA**

- Përmirësimi i mëtejshëm i kërkimit shkencor dhe zgjerimin e burimeve për materialet kërkimore
- Përmirësimi i procesit të përzgjedhjes së studentëve që njohin gjuhën angleze në nivele të kënaqshme
- Të sigurohet që studentët dorëzojnë në fund të programit një certifikatë për njohuritë në gjuhën angleze e cila njihet në nivel ndërkombëtar.

### **II. Analiza përmbledhëse për plotësimin e rekomandimeve nga akreditimi i parë**

GVJ duke u bazuar në RVB, Dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën pranë Universitetit EPOKA, konstaton se rekomandimet e mëparshme janë plotësuar

1. Më konkretisht, rekomandimi i parë është plotësuar duke parë shtimin dhe përmirësimin e laboratorit të inxhinierisë së ndërtimit si një mjet që nxit dhe stimulon kërkimin shkencor. Gjithashtu biblioteka e Universitetit EPOKA është pasuruar ndjeshëm me tituj në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit.
2. Lidhur me rekomandimin e dytë, niveli i gjuhës angleze, tanimë është detyrim ligjor për të gjitha institucionet e arsimit të lartë, dhe për rrjedhojë institucioni nuk bën përjashtim dhe i ka të rregulluara kushtet duke pas parasysh që programi zhvillohet në gjuhën Angleze.
3. Rekomandimi i tretë, tanimë është kusht hyrës në një Master Shkencor. Pa dorëzuar certifikatën e njohjes së gjuhës Angleze një Student nuk mund të jetë pjesë e një programi master.



## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Programi i Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" me dy profile "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit" dhe "Menaxhim i Ndërtimeve" është aktivizuar në vitin 2010 duke u akredituar në vitin 2012. Nga viti 2016-2017 e zgjeruar edhe me profilet Inxhinieri e Resurseve Ujore dhe Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit. Këto dy profile e kanë fituar të drejtën për të regjistruar studentë në Mars të vitit 2018. Për vitin akademik 2018 – 2019 profili "Inxhinieri e Resurseve Ujore" ka 5 studentë të regjistruar ndërsa profili Inxhinieri e Materialeve nuk ka asnjë student të regjistruar.

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm citohet:

*Qëllimi i këtij programi është që vazhdimisht të pajisë studentët me njohuri më të gjera dhe më të thella, me aftësi dhe qasje, që mundësojnë një funksionim më efektiv në mjedisin sfidues të dekadave të ardhshme të inxhinierisë së ndërtimit. Studentët e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë pritet të jenë studiuesit dhe specialistët lider në këtë fushë.*

*Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi (MSc) në Universitetin EPOKA, i orientuar drejt praktikës, është një zgjatim i arsimit universitar dhe mundëson studime më të avancuara në një nga degët e inxhinierisë së ndërtimit.*

*Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi (MSc) është konceptuar për studentët e diplomuar në nivelin Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi apo në një degë tjetër të afërt, për të forcuar njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e parimeve dhe praktikave të inxhinierisë së ndërtimit. Programi është konceptuar kryesisht për ato student të cilët janë apo synojnë të bëhen inxhinierë ndërtimi në praktikë, prandaj programi fokusohet tek aplikimi i këtyre parimeve dhe praktikave në problemet reale që ndeshin inxhinierët profesionistë të ndërtimit.*

*Një qëllim tjetër i këtij programi është të mundësojë kërkimin e aplikuar shkencor për temat përkatëse të inxhinierisë së ndërtimit. Këto kërkime shkencore duhet 1) ti shërbejnë nevojave të shoqërisë duke trajtuar çështjet bashkëkohore, 2) të kontribuojnë në zhvillimin Profesional të studentëve dhe të fakultetit dhe 3) të ofrojnë përgatitje për studime akademike të mëtejshme dhe kërkim shkencor për ato studentë që duan të vazhdojnë studimet e doktoraturës (PhD).*

*Të gjitha strategjitë institucionale të Universitetit "Epoka" bazohen në trekëndëshin "Mësimdhënie, Kërkim Shkencor dhe Kontribut për Shoqërinë".*

Nga informacioni i marrë gjatë vizitave në institucion dhe nga RVB, disa nga objektivat kryesorë të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit" (më tej Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile) janë:

1. T'u sigurojë studentëve njohuri të mjaftueshme për parimet e inxhinierisë, për të kuptuar bazën dhe zbatimin e analizave dhe dizajnit standard si dhe praktikën e zbatimit.
2. Të aftësojë studentët për të kryer analiza inxhinierike dhe për të hartuar dhe zbatuar projekte dhe zgjidhje problemesh në përputhje me kodet që zbatohen dhe standartet e praktike.
3. Të përgatisë studentët që të kuptojnë faktorët e ndryshëm teknik dhe jo teknik që ndikojnë në praktikën dhe zbatimin e projekteve të inxhinierisë së ndërtimit, duke përfshirë: zbatimin teknik, përfshirjen shumëpalëshe, vlerësimin mjedisor, planifikimin financiar/ekonomik, administrimin e punëve publike/private, planet strategjike të investitorit dhe çështje të paanshmërisë/ social-ekonomike.
4. Të zhvillojë gjykimin inxhinierik me anë të praktikës si dhe të identifikojë me efikasitet dhe të marrë parasysh objektivat e shumta dhe konkurruese.
5. Të aftësojë studentët me njohuritë dhe aftësitë teknike për të ndjekur të nxënit gjatë gjithë jetës me aftësinë për të zgjeruar në mënyrë të pavarur dijet personale dhe të kuptuarit e temave dhe



praktikave inxhinierike duke kryer kërkime në literaturë, konsultime me të tjerët dhe duke përdorur teknika të tjera të ngjashme.

6. Të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kaluar provimet e licensimit profesional në fushën e tyre përkatëse.

Grupi i jashtëm i vlerësimit konstaton se Misioni i Institucionit është në përputhje me programin e studimit, ndërsa objektivat e programit të studimit përputhen me kurrikulën si dhe lëndët/ modulet e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile.

Gjithashtu GVJ gjykon se misioni dhe objektivat janë hartuar në përputhje me llojin dhe nivelin e programit të studimit në fjalë, duke i mundësuar studentëve njohuri të thelluara teorike dhe veçanërisht aftësi profesionale praktike për të garantuar karrierë të suksesshme në organizma si të sektorit privat ashtu edhe atij publik.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Misioni i Universitetit EPOKA: <i>të jetë një institucion mësimor-kërkimor inovativ dhe me ndikim, në shërbim të vlerave njerëzore thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar, si dhe të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare dhe rajonale. Në këtë kuadër, Universiteti "Epoka" synon të rrisë individë të mirëkualifikuar, produktivë dhe të aftë, me shpirt të orientuar drejt kërkimit, etikë profesionale dhe ndjeshmëri shoqërore, si dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare</i></p> <p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni mbështetës (Rregullorja e programit) dhe (Statuti i Universitetit Epoka), u konstatua se Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit", të Universitetit "EPOKA", është hartuar në përputhje me Statusin e Universitetit EPOKA, neni 3, misionin dhe qëllimet e institucionit.</p> <p>Bazuar në Misionin dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit EPOKA hartimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Inxhinieri Ndërtimi", "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit" është realizuar sipas nevojave të tregut.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit mban komunikimi të ngushtë me kompanitë e ndërtimit që operojnë në treg, përmes një konsultimi të vazhdueshëm me to në lidhje me nevojat e tyre, mundësitë e reja dhe bashkëpunimin me to.</p> <p>Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe të saj jashtë vendit si dhe me kompani</p>



	<p>vendase ose të huaja në të mirë të programit të studimit. Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të fushave të Inxhinierisë së Ndërtimit, ndërsa IAL ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund t'i shërbejnë kërkesave të tregut të punës. Nëpërmjet Dekanit të Studentëve, Institucioni krijon marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të Inxhinierisë së Ndërtimit. Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me kompanitë dhe punëdhënësit me anë të marrëveshjeve të ndërsjella.</p> <p>Kjo bazuar në statutin e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi Master i Shkencave në "<i>Inxhinieri Ndërtimi</i>", me profile të Universitetit "EPOKA", është pjesë integrale e strategjisë së zhvillimit të Universitetit Epoka dhe ka të përcaktuara objektivat për edukimin e inxhinierëve duke u mbështetur në arritjet më të fundit shkencore në inxhinierinë e ndërtimit dhe në të njëjtën kohë duke shtuar kompetenca më të veçanta për studentët me njohurit e përgjithshme.</p> <p>Strategjia 2017-2022 e Universitetit EPOKA e zbërthyer në misionin, qëllimet, vizionin, burimet, arritjet e periudhës së fundit, fushat me prioritet sikur janë: sigurimi i cilësisë së lartë për mësimdhënie dhe nxënie, qëllimet e trajnimit të stafit akademik, etj janë pjesë e kurrikulës së masterit shkencor të inxhinierisë së ndërtimit dhe grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se ky program i studimit përputhet në plotëni me strategjinë e Institucionit.</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në "<i>Inxhinieri Ndërtimi</i>", me profile përputhet plotësisht me kriteret e caktuara dhe aktet nënligjore në fuqi. Ky program është ndërtuar duke respektuar dhe zbatuar ligjin për Arsimin e Lartë si dhe aktet e tjera për të pasur një pajtueshmëri të plotë me to.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p> <p>Programi i Studimit të Ciklit të Dytë në Inxhinieri Ndërtimi përkon me Nivelin e 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të</p>	<p>Universiteti EPOKA ka planin strategjik të hartuar për periudhën 2017-2022 për inxhinierinë e ndërtimit, me përmbajtje të qëllimeve për arritje institucionale duke ju referuar rritjes së cilësisë institucionale duke përdorur</p>



mësimdhënies dhe të të nxënës.

instrumentet matëse adekuat, rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënës. <http://ce.epoka.edu.al/home--strategic-plan-2017-2022-0-202.html>

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Institucioni ofron program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Gjatë vizitës por dhe shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua se Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit", përputhet plotësisht me misionin dhe objektivat e Institucionit.

GVJ konfirmon se Universiteti EPOKA, departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, ka një strategji të zhvillimit për periudhën 2017-2022, e hartuar me profesionalizëm duke përfshirë çdo fushë e cila ka të bëjë me zhvillimin akademik shkencor, mësimdhënies, nxënës, dhe rritjes së cilësisë së produktit.

Programi në fjalë është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore të tij, si dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit EPOKA.

## **2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)**

Universiteti "Epoka" përbëhet nga tri Fakultete dhe secili prej tyre përbëhet nga të paktën tri departamente si njësi themelore. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë është njësi kryesore brenda së cilit është vendosur dhe menaxhohet Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit".

Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Autoriteti drejtues akademik i fakultetit është Dekanati. Dekanati i Universitetit EPOKA është organ ekzekutiv kolegjal i njësive kryesore përkatëse. Dekanati përbëhet nga udhëheqësi përkatësish Dekani, zëvendës Dekani, Administratori i njësisë kryesore dhe përgjegjësit e departamenteve.

Dekani është autoritet udhëheqës i Fakultet, i cili prezanton dhe përfaqëson Fakultetin. Dekani është gjithashtu pjesë e stafit akademik me titullin Profesor i Asocuar.

**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISE** përbëhet nga:

- 1) Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit (përgjegjës për programin)
- 2) Departamenti i Arkitekturës
- 3) Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike

Grupi i vlerësimit të jashtëm duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar së bashku me RVB si dhe në takimet me stafin dhe dokumentet e vëna në dispozicion gjatë vizitës së kryer pranë ambienteve të Universitetit EPOKA, konstatoi se të tre njësitë themelore të Fakultetit përkatësisht Departamentet kanë në përbërje të tyre staf akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Secila njësi bazë plotëson kushtet e përcaktuar nga ligji ku minimumi tre pjesëtarë të stafit akademik të jenë me gradën shkencore "Doktor".

Gjithashtu u konstatua se profili i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhet më së miri me programin Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile Kjo ndikon në përmbushjen e standardeve të programit.



Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga Personel Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë. Personel Akademik me Kontratë përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, pedagogët dhe lektorët e ftuar.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Struktura akademike e Fakultetit

Në departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit Personeli Akademik i angazhuar përbëhet prej 20 pedagogesh nga të cilët 12 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 8 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK). Raportet mes Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë 12/8 ose 66.6 % janë PAE ndërsa 33.4 % janë PAK.

Personelin Akademik Efektiv (PAE) e përbejnë; 2 Profesor të Asocuar, 5 pedagog me doktoratë dhe 5 asistent me MSc. Ndërsa Personelin Akademik me kontrate (PAK) e përbejnë; 1 Profesor i Asocuar, 6 Profesor me gradën shkencore doktor .

Personeli Administrativ i departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit është i përberë nga 5 punonjës. Raportet e Personelit Akademik ne nivel Departamenti me Personel Administrativ është  $(12+8)/5=4$ . Raporti Student me Personel Administrativ 13/5 rezulton 2.6 student/1 personel administrativ, (ku 13 është numri i studenteve ne total për dy vitet Akademike për 2016/2017 dhe 2017/2018).

Personeli Akademik ka ngarkese vjetore 24 deri 338 ore mësimore me një mesatare prej 160 orë vjetore. Ndërsa Programi i studimit për të profilet "Inxhinieri e Strukturave te Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit" ka ngarkese vjetore ne total 1320 orë (Leksione, Seminare, Detyrat, Punë në Laboratorë, Praktika e Lëndës, Praktika Profesionale).

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Universiteti "Epoka" është i organizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</p> <p>Universiteti EPOKA ka stafin e tij të përhershëm akademik dhe ai me kontratë, administratën dhe menaxhmentin që janë të përkushtuar në respektimin e qëllimeve të përcaktuara qartë si dhe ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies duke synuar realizimin e objektivave nga strategjitë e tyre.</p> <p>Institucioni ka në strukturën organizative tri fakultete (Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administratës dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale).</p> <p>Çdo Fakultet ka nga tre departamente.</p> <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Arkitekturës dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike.</p> <p>Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë përbëhet prej stafit Akademik Efektiv (PAE); 2 Profesor të Asocuar, 5 pedagogë me doktoratë dhe 5 asistent me MSc.</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Në takimet me stafin dhe duke u bazuar në dokumentacionin përkatës (Statutin e Universitetit EPOKA, Rregulloreve funksionale) u konstatua se Fakulteti përgjegjës Fakulteti Arkitekturës dhe Inxhinierisë përkatësisht Departamenti i cili merret me organizimin dhe menaxhimin e programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile, janë plotësisht të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë dhe detyrimet që kanë për realizimin e programit duke respektuar dhe kjo është treguar në mënyrë kohezive në vitet paraprake të veprimtarisë lidhur me programin e studimit.</p> <p>Gjatë takimit me stafin menaxherial si dhe me stafin Akademik të Fakultetit janë zbërthyer metodologjitë e rekrutimit të personelit Akademik, procedurat ligjore për arritjen e një kontrate, kriteret, rangimet e konkurrencës. Ky proces u verifikuar bazuar dhe në dokumentacionin mbështetës që u pa në zyrën e Burimeve Njerëzore.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Institucioni është i organizuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të tij. Gjithashtu përmbushë standardet lidhur me organizimin e brendshëm të tij duke qenë pjesë përbërëse të tij tre Fakultete me përbërje nga tre departamente për secilin fakultet në veçanti, ndërsa të lidhura dhe funksionale me Administratë e cila ka njësitë e veta që janë në shërbim të përmbushjes së misionit të Universitetit përkatësisht të programit studimor Inxhinieri e Ndërtimit me profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit".</p> <p>Standardi për numrin e personelit akademik të rregullt plotësohet dhe është i rregulluar me kontrata të rregullta pune duke respektuar të gjitha ligjet dhe normat ligjore në vend.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion është vërejtur përkushtimi maksimal i stafit Akademik të rregullt për përmbushjen e misionit dhe objektivave për këtë program studimi "Inxhinieri Ndërtimi", kjo duke dëshmuar edhe sukseset e tyre.</p>	

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga Personel Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë. Personel Akademik me Kontratë përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, pedagogët dhe lektorë.

Duke qenë se mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze, kërkesë e punësimit në këtë program studimi është njohja e gjuhës në nivelin C1 e të gjithë stafit akademik dhe administrativ.

Ngarkesa e mësimdhënies për personelin Akademik është në pajtim me kontratën, dhe për personelin me gradën: Profesor, Profesor i Asociuar, dhe Dr është 16 orë në javë, ndërsa për asistentët 20 orë në javë. Ngarkesa në orë për stafin akademik menaxherial është: Rektor 6 orë, zv/Rektor 9, Dekani 9 orë, udhëheqësi i departamentit 12 orë.

Stafi Akademik Efektiv përveç detyrimeve mësimore kanë angazhime edhe në fushat tjera sikur janë marrëdhëniet ndërkombëtare të institucionit përkatësisht të Universitetit EPOKA, dhe me kryesorja, Personeli Akademik Efektiv një kohë të konsideruar e bënë në kërkime shkencore, pjesëmarrje në konferenca Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Disa nga Personeli Akademik kanë angazhime edhe rreth



menaxhimit të vetë Departamentit, Fakultetit përkatësisht Universitetit duke qenë koordinatorë të programeve, udhëheqës të Departamenteve, komisioneve brenda njësive Akademike etj.

Për rekrutimin e Personelit Akademik nga Universiteti EPOKA ekzistojnë procedura ligjore, transparente, të cilat realizohet edhe përmes detyrave kontraktuale për secilin person, ndërsa metodikat didaktike në shumë raste freskohen (përmirësohen) forcohen me metoda të avancuara të dhënies së mësimi, vlerësimit të studentëve.

Institucioni administron nevojat e Universitetit përkatësisht Fakulteteve përkatëse dhe departamenteve të tyre me një administratë shumë funksionale e cila respekton në tërësi ligjet shtetërore si dhe detyrimet Institucionale duke siguruar cilësi, shpejtësi dhe saktësi të shërbimit. Numri i administratës për programin e studimit është 5 veta dhe duke krahasuar vitet akademike 2016/2017 dhe 2017/2018 numri i studentëve është 13, pra raporti studentë/ administratë është 13/5 dhe është tregues i mirë i performancës së shërbimit.

Viti Akademik organizohet në semestra dhe me më së paku 20 orë mësimi për javë (ligjëratë, seminare dhe laboratorë).

Në RVB jepet:

- Raporti PAE/PAK në program është 7/1
- Raporti personel akademik/personel administrativ është 8/5
- Raporti personel akademik/student është 8/22
- Raporti personel administrativ/student është 5/22

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit Msc në Inxhinieri Ndërtimi, me profile, të hartuara nga IAL realizohen nëpërmjet shërbimeve Administrative si dhe personelit Akademik të angazhuar.</p> <p>Rekrutimi i Personelit Akademik kryhet sipas proceduarve ligjore në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Institucionit.</p> <p>Stafi akademik dhe administrativ i programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi është i përzgjedhur për të përmbushur objektivat e programit. Stafi akademik është i specializuar në fushat përkatëse të shkencës për të dhënë leksionet dhe seminarët e programit, që janë specifike për këtë program.</p> <p>Objektivi i Masterit të Shkencave në “Inxhinieri Ndërtimi”, me profile është fuqizimi i njohurive dhe dijeve të studentëve dhe zbatimi i tyre në praktikë, si dhe lehtësimi i kërkimit shkencor në tema të Inxhinierisë së Ndërtimit, për të arritur nivel më të lartë të kompetencave në fushat më të gjëra të Inxhinierisë së Ndërtimit përmes Lëndëve dhe moduleve teorike, ushtrimeve numerike, Laboratorëve, punës praktike, vizitave në kantiere si dhe një mori aktivitësh të tjera, që çojnë drejt arritjes së këtij qëllimi të përgjithshëm.</p> <p>Institucioni ka të gjithë dokumentacionin lidhur me rekrutimin e personelit Akademik dhe Administrativ.</p>
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit</b>	



**të institucionit.**

**Kriteri 1** Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Stafi akademik i programit organizon takime të rregullta të Departamentit për të diskutuar kurrikulën e programit Master.

Si nevojë e funksionimit të drejtë të programit IAL ka udhëheqësin e departamentit i cili udhëheq programin studimor me qëllim funksionimin e drejtë të programit.

Udhëheqësi i departamentit të programit kujdeset se bashku me stafin Akademik dhe Administrativ që të freskojë kurrikulën dhe të organizojë programin e studimit. Nga viti i parë i studimeve janë bërë ndryshime në vitin e dytë (jo më shumë se 20%) me qëllim të arritjes së objektivave në mënyrë sa më të përsosur duke ndërruar ose shtuar lende dhe module studimi.

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi është shtytësi kryesor që çon më tej përmbushjen e Objektivave kryesore dhe të veçanta. Në çdo fillim viti akademik diskutohen syllabuset e çdo lënde në grupe të ngushta në mënyrë që vazhdimisht të përmirësohen dhe përsosën rezultatet e nxënies.

Institucioni ka rregulloren "Për punësim dhe Vlerësimin e Performancës së Personelit Akademik" për rekrutimin e personelit Akademik. Zgjedhja e personelit Akademik bazohet në procedurë ligjore.

Institucioni ka rregulloren "*Basic regulation*" FU-REG-001-EN e fuqizuar datë 21.09.2007 dhe e amenduar 4 here, e fundit datë 22.10.2012, përveç tjerash, në të cilën specifikohen kuptimet dhe përmbajtjet e thirrjeve akademike, etj. Në këtë rregullore, Neni 9, alinea 2 shkruan se kriteret e konkursit propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani. Më tutje në këtë rregullore përshkruhen në formë të përgjithësuar se si formohen komitetet e konkursit si dhe kandidatët e zgjedhur fillimisht merren dhe nënshkruajnë kontratë për periudhë kohore prej gjashtë deri në një vit. Pas kompletimit të kontratës dhe kushteve të kontratës i punësuarit me gradë shkencore mund të nënshkruajë kontratë me kohëzgjatje prej pesë viteve ose kontratë të pa kufizuar. Lektorët pa thirrje shkencore mund të punësohen dhe të lidhin kontratë me kohë të caktuar, jo më shumë se një vit me mundësi përsëritje.

**Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedurë ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.**

**Kriteri 1** Institucioni ndjek procedurë ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

**Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

**Kriteri 3** Institucioni ndjek procedurë ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Procedurat ligjore për rekrutimin e personelit Akademik janë në përputhje ligjore duke përshkruar se Institucioni bënë shpalljen publike të njoftimit për punësim në rrjetet sociale si dhe ëb faqen e Universitetit EPOKA dhe se Institucioni bashkëpunon edhe me zyrën Rajonale të Shërbimit kombëtar të Punësimit në Tiranë.

Institucioni ka rregulloren "Për punësim dhe Vlerësimin e Performancës së Personelit Akademik" për rekrutimin e personelit Akademik. Zgjedhja e personelit Akademik bazohet në procedurë ligjore.



**Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

Procedurat ligjore për rekrutimin e stafit akademik (sipas RVB) të cilat janë transparente dhe të radhitura sikur në vazhdim:

- Kërkesa për personel nga Departamenti/Fakulteti;
- Nga Zyra e Burimeve Njerëzore shpallet vendi i lirë i punës dhe publikohet në faqen eeb;
- Kandidatët e mundshëm aplikojnë duke dërguar dokumentacionin e kërkuar përmes formës elektronike "online" ose edhe të printuara;
- Aplikimet vlerësohen paraprakisht nga një juri e përbërë nga tre anëtarë të emëruar nga Dekanati i Fakultetit përkatës dhe harton raport vlerësimi për secilin kandidat;
- Dekanati shqyrton raportet e vlerësimit të bëra nga juria dhe i dërgon për vendim te Rektorati;
- Rektorati dërgon propozimin me shkrim Bordit të Administrimit të Universitetit i cili jep miratimin përfundimtar;
- Me dërgimin e vendimit të marrë nga Bordi i Administrimit të Universitetit te Zyra e Burimeve Njerëzore, fituesi dërgon edhe dokumente të tjera të kërkuara dhe më pas ai/ajo regjistrohet si pedagog me kohë të plotë apo të pjesshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Zyra e Financës përgatit kontratën;
- Zyra e Burimeve Njerëzore harton letër-emërimin dhe njofton me email të gjithë stafin për pedagogun e sapoemëruar.

Personeli Akademik i angazhuar në programin e Studimit në Inxhinieri Ndërtimi (shih ne aneks, tabelat 7.1-7.6):

- për vitin shkollor 2012-2013 përbëhej prej 4 pedagogesh nga të cilët 3 ishin Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 1 ishte Personel Akademik me Kontratë (PAK). Raportet mes PAE dhe PAK janë 3/1, ose 75.0 % PAE ndërsa 25.0 % PAK.
- për vitin shkollor 2013-2014 përbëhej prej 11 pedagogesh nga të cilët 7 ishin PAE dhe 4 ishin PAK. Raportet mes PAE dhe PAK, 7/4, ose 63.64 % PAE ndërsa 36.36 % PAK.
- për vitin shkollor 2014-2015 përbëhej prej 6 pedagogesh nga të cilët 5 ishin PAE dhe 1 ishte PAK. Raportet mes PAE dhe PAK, 5/1, ose 83.33 % PAE ndërsa 16.67 % PAK.
- për vitin shkollor 2015-2016 përbëhej prej 8 pedagogesh nga të cilët 5 ishin PAE dhe 3 ishin PAK. Raportet mes PAE dhe PAK, 5/3, ose 62.50 % PAE ndërsa 37.50 % PAK.
- për vitin shkollor 2016-2017 përbëhej prej 12 pedagogesh nga të cilët 8 PAE dhe 4 PAK. Raportet mes PAE dhe PAK janë 8/4, ose 66.67 % janë PAE ndërsa 33.4 % janë PAK.
- për vitin shkollor 2017-2018 përbëhej prej 8 pedagogesh nga të cilët 7 PAE dhe 1 PAK. Raportet mes PAE dhe PAK janë 7/1, ose 87.5 % janë PAE ndërsa 12.5 % janë PAK.

Numri i personelit Akademik i angazhuar në programin e studimit Inxhinieri të Ndërtimit ka lëviz nga viti në vit dhe ka plotësuar



	<p>pjesërisht kriteret ligjore përsa i përket raportit të PAE dhe PAK.</p> <p>Vlerësuar nga fillimi i studimeve në programin në Inxhinieri Ndërtimi në vitin 2012 deri në momentin e vlerësimit të raportit 2018, Raporti i Personelit Akademik të Angazhuar me Personelin Akademik me Kontratë nuk ka plotësuar kriterin ligjor prej 70% edhe pse shumë afër.</p> <p>Këtë vit akademik i gjithë procesi mësimor mbulohet nga personeli akademik efektiv, ndërsa ka të angazhuar vetëm një pedagog.</p> <p>Gjatë vizitës në instucion u kërkua dosja e personelit PAK dhe na u tha që profesori në fjalë nuk zhvillon mësim por është thjesht tutor i një teme masteri, dhe për rrjedhojë vlerësimi i raportit PAE/PAK për programin e studimit është 7/0.</p> <p><i>Sugjerohet që nëse një profesor nuk zhvillon mësim por thjesht ndjek një student ai/ajo të mos konsiderohet fare si staf PAK ose të vihet një shënim përkarshi që është thjesht në proces ndjekje teme diplome. Për rrjedhojë raporti PAE/PAK për programin e studimit është 7/0</i></p> <p>Gjithshtu Universiteti ka detyrim tanimë që vëndet vakante t'i publikojë edhe pranë zyrës së punësimit dhe instucioni e kryente këtë procedurë.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion vërtetimi i procedurave për mënyrën e zgjedhjes ka qenë në vlerësimin e ekzemplarëve të rastësishëm dhe kemi gjetur se vlerësimi i stafit Akademik ka qenë transparent, i paanshëm dhe ka siguruar cilësi në arritjen e Objektivave.</p> <p>Institucioni ka të arkivuar (në zyrën e Burimeve Njerëzore) dhe janë konfidenciale të gjithë dokumentacionin e personelit akademik efektiv, personelin akademik me kontratë, stafin administrativ. Gjatë vizitës janë kontrolluar dhe verifikuar disa dosje të dokumentacionit të PAE dhe PAK. Administrata e Universitetit është e rregullt në mbajtjen e datotekës së përgjithshme të të punësuarve në Institucion. Shënimet janë vërtetuar nga rasti në rast.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani,</p>	<p>Përgjegjës për programin e studimeve Master i Shkencave për Inxhinierinë e Ndërtimit me profile është me titullin Prof.asoc.Dr.</p> <p>Në përmbajtjen e lëndëve të kurrikulës "Master i Shkencave për Inxhinieri Ndërtimi" të gjithë bartësit e lëndëve janë me gradë shkencore Doktor.</p> <p>I gjithë Institucionit udhëhiqet nga Bordi Administrativ, Rektorati, Dekananti, i cili përbëhet nga stafi akademik i cili ka tituj/gradë shkencore Prof. Dr/ Profesor i asociuar/ Doktor dhe të gjithë janë të punësuar me kohë të plotë pranë Universitetit EPOKA.</p> <p>Praktikat profesionale studentët i realizojnë jashtë institucionit, ndërsa laboratorit brenda institucionit ndihmon studentet për praktikë.</p>



<p>zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Në semestrin e 1 të vitit të dytë të studimeve në kurrikulën e programit Inxhinieri Ndërtimi është kursi Term Projekt, i cili ka 10 ECTS dhe studenti duhet të bëjë punë në laborator (50 orë pune të pavarur) dhe 200 orë pune në praktikën profesionale. Pas përfundimit të praktikës bëhet raporti nga studenti dhe i njëjti vlerësohet nga pedagogu të i cili studenti ka punimin e tezës dhe vlerësohet me notë.</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Temat e diplomave në programin e studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi zhvillohen gjatë gjithë vitit të fundit të studimit. Studentëve të programit të studimit "Inxhinieri Ndërtimi" në përputhje me interesat e tyre ju caktohet një personel Akademik për udhëheqës në semestrin e parë të vitit të dytë. Përcaktimi i studentëve për profilin e studimit bëhet që nga fillimi i studimeve në vitin e parë.</p> <p>IAL ka të krijuar Format për studentët që kanë mbërritur kushtet për tezën dhe janë sikur në vazhdim: formati GS 2 për nominimin e supervisorit në të cilën Studenti plotëson shënimet personale dhe miratohet nga Supervisorin, udhëheqësi i departamentit dhe Dekani. Pastaj formati GS 2b paraqitet në formë të shkruar propozimi për hulumtim. Formatu GS 3a plotësohet dhe është kërkesë për ekzaminim të tezës dhe miratohet nga komiteti i supervizionit për vlerësim. Formatu GS 3c është forma përfundimtare e parashtrimit të tezës. Në ëb site të Universitetit është shablloni (template) për punimin e diplomës.</p> <p>Mësimdhënësi mbështet punën kërkimore të studentit dhe përgatitjen e tezës e cila përfundon me ciklin e studimeve. Takimet Profesor-student janë të rregullta me qëllim këshillimin rreth problemeve shkencore, hulumtuese të temën e diplomës. Supervisorët janë staf akademik me grada Dr, Prof.asoc.Dr.</p> <p>Supervisorin mbikëqyr jo më shumë se 5 (pesë) student njëkohësisht. Aktualisht 16 studentë masteri janë në fazën e shkrimit të tezës. Numri i supervisorëve është 6. Një supervisor mbikëqyr nga 1 deri në 4 studentë.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Stafi Akademik i angazhuar (Efektiv apo me kontrate) ka përgatitje profesionale të fushave përkatësisht disiplinave shkencore që i takojnë shkencës së Strukturave, Materialeve, Hidroteknikës dhe Menaxhimit (Lëndët/modulet profesionale).</p> <p>Kompetencat e stafit Akademik sidomos në fushat e ngushta profesionale ju ofrojnë Studentëve qasje dhe rezultate të nxënies bashkëkohore në: Projektimin e Strukturave, Konstruksionet Hidroteknike, Mbikëqyrje profesionale, Menaxhim në Ndërtim, Materialet në ndërtim, Teori të avancuara të Strukturave, verifikim</p>



	<p>të strukturave ekzistuese etj.</p> <p>Gjithashtu dhe Udhëheqësit e Universitetit, Fakultetit dhe Departamentit janë të fushave Arkitektonike dhe Inxhinierike të cilat fusha janë të shtrira edhe në Objektivat e profileve si dhe në Misionin e Institucionit.</p> <p>Në fillim të vitit të dytë të studimeve studentëve ju ofrohen orientimet e temave të mundshme për diplomë në lëndën "Master Thesis". <i>Këtu sugjerohet që të ketë një listë fushash për temat e diplomave të aprovuara nga departamenti përkatës. Kjo do ju ndihmoj studentëve të kenë një përzgjedhje më të lehtë dhe gjithashtu ndihmon institucionin që të shmang mbivendosjen e temave të kërkimit nga viti në vit.</i></p> <p>Për të qenë të përditësuar me tendencat e kërkimit shkencor, stafi akademik vazhdon punën me zhvillimin e aktiviteteve të tyre kërkimore, merr pjesë rregullisht në aktivitete/ evente shkencore dhe botojnë punimet e tyre shkencore në revista akademike të njohura.</p>
--	--

**Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Brenda kampusit të Universitetit gjendet Laboratori i materialeve, konstruksioneve, gjeoteknikës dhe gjeodezisë. Kurset të cilat kanë në përbajtje ushtrimet laboratorike organizohen nga pedagogët e tyre, në mbështetje të personelit ndihmës mësimor ose edhe shkencor.</p> <p>Ky laborator i inxhinierisë së ndërtimit ju shërben jashtëzakonisht shumë studentëve për ngritjen e cilësisë së studimit dhe nxënie gjatë rrjedhës së studimeve, duke u familjarizuar me ekzaminimet e ndryshme të materialeve, eksperimentet e ndryshme, matjet e rezistencave tv materialeve etj.</p> <p>Në rast të nevojës për të mbuluar kurse specifike Universiteti EPOKA i mbështet departamentet me personel me kohë të pjesshme, ose rekruton personel shtesë për të mbështetur stafin aktual.</p> <p>Të gjitha këto shërbime që ju ofrohen studentëve, kanë për qëllim që të jetë siguruar cilësia e mësimdhënies, dëshira për të studiuar thellësisht dhe arritja e kompetencave profesionale në nivelin çfarë kërkon tregu vendor dhe i jashtëm.</p>
--	---

**Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Gjatë gjithë kohës (orarit të plot të punës) personeli Akademik si dhe Administrata janë prezentë në Fakultet. Ngarkesa e mësimdhëniesit (varësisht nga natyra e Lëndës/Modulit dhe Personelit Efektiv dhe Personelit me kontratë) rezulton rreth 16 orë/javë mësimi. Vlera mesatare e ngarkesës së Personelit Akademik është rreth 160 orë vjetore e që është në përputhje me aktet nënligjore për aktivitetet dhe standardet mësimore të Personelit Akademik, për këtë nivel të arsimit.</p>
--	---



	<p>Numri i Studentëve në vitet shkollore 2016-2018 për të dy profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit" dhe "Menaxhim i Ndërtimeve" është 13. Raporti pedagog/student është 13/20 (pasi për dy profilet e tjera: c) "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit" dhe d) "Inxhinieri e Resurseve Ujore" nuk ka asnjë student të rregjistruar deri në shtator 2018).</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019:</p> <p>a) "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit" ka 8 studentë  b) "Menaxhim i Ndërtimeve" ka 0 studentë  c) "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit" ka 0 studentë  d) "Inxhinieri e Resurseve Ujore" ka 5 studentë</p> <p>IAL ka rregulloren për ngarkesën mësimore EU-DIR-011-EN, datë 08.10.2009, e përditësuar 07.10.2016, e cila saktëson kriteret për llogaritjen e ngarkesës mësimore për PAE dhe PAK. Ngarkesa për pedagogun mund të jetë deri në 16 orë në javë. nëse ngarkesa është më e madhe, atëherë orët shtesë paguhen. Kjo rregullore përcakton ngarkesën mësimore edhe në baza e funksioneve menaxhuese të IAL. Ngarkesa e orëve mësimore është me bazë javore dhe përcaktohet në kontratat e veçanta të personelit akademik.</p> <p>Mbikqyrja e tezës nuk përfshihet në llogaritjen e ngarkesës mësimore, me përjashtim kur supervizori ka më shumë mbikqyrje tezash se sa e parashikon rregullorja.</p>
--	--


**Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>IAL për të gjithë Personelin Akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, Efektiv apo me Kontratë të pjesshme dhe Personelin e Administratës, plotëson dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga Zyra Rajonale e Punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuar si dhe dokumente të tjera të kërkuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Pas përfundimit të procedurave të punësimit, Zyra e Burimeve Njerëzore hedh në Sistemin Interaktiv të Universitetit të gjitha të dhënat e personelin akademik të punësuar si: datën e lindjes, vendlindjen, arsimimin, emërimin, lejen e qëndrimit të personelit të huaj dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme.</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e stafit Akademik janë publike dhe kushdo që ka interesim për to mund të marr informatën nga mediat sociale si dhe nga ëeb faqja elektronike e Institucionit.</p> <p>Institucioni disponon një listë të plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe të personelit administrativ për secilin semestër. Kjo listë gjendet tel Zyra e Burimeve Njerëzore.</p>
--	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ konstaton se Personeli Akademik dhe personeli mbështetës i programit të studimit, të angazhuar në mësimdhënie dhe në aktivitetet tjera përcjellëse për nevojat e IAL, përkatësisht studentëve janë të përgatitur profesionalisht dhe me gradë e cila kërkohet edhe nga standardet për Master i Shkencave

Faqe 18





dhe më specifikiisht për profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit".

Ata rekrutohen me procedura të rregullta dhe transparente të cilat sigurojnë një cilësi të mirë për studentët dhe aktivitetet akademike.

Administrata e institucionit është profesionale, garanton shërbime të shpejta, cilësore, efikase dhe të sigurta. Nga vizita e bërë vërehen cilësi në shërbime, siguri të informacionit, pacënueshmëri të të dhënave personale të individëve dhe një hierarki të urdhrave dhe funksioneve respektuese.

Përveç angazhimeve mësimore Stafit Akademik ka detyrime edhe në fushën e kërkimeve shkencore si pjesëmarrja në aktivitete hulumtuese dhe shërbimeve tjera profesionale, të cilat plotësojnë misionin dhe objektivat e Institucionit.

Organizimi i temave të diplomave, puna intensive përmes takimeve të progreseve të tyre dëshmon punën dhe përkushtimin e Stafit të IAL për të arritur objektivat në kurrikulat mësimore dhe kompetencat të produkti i tyre.

Ndërsa nga pikëpamja e menaxhimit (arkivimit-ruajtjes-sistemimit) të dokumentacionit, proceduarave të rekrutimit të Personelit dhe të dhënave për kualifikimin e Personelit Akademik çdo gjë është në rregull.

Rekomandime/ sugjerime:

- *Sugjerohet që nëse një profesor nuk zhvillon mësim por thjesht ndjek një student ai/ajo të mos konsiderohet si staf PAK ose të vihet një shënim përkarshi që është thjesht në proces ndjekje teme diplome.*

#### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Universiteti EPOKA ndodhet në rrugën Tiranë Rinas afër aeroportit ndërkombëtar të Tiranës. Kampusi shtrihet në një sipërfaqe prej 67,000 m<sup>2</sup> dhe kampusi ofron një kompleks të ndërtesave me funksione të ndara.

GVJ vizitoi ambientet e universitetit si klasat, auditorët, laboratorët, sallat e studimit, bibliotekën, hapësirat e administratës por dhe hapësirat e tjera të përbashkëta, ku studentëve ju ofrohet një infrastrukturë e përshtatshme dhe bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha disiplinat, mjedise të brendshme dhe të jashtme të cilat mund të konsiderohen tepër cilësore dhe plotësojnë më së miri kushtet për studim dhe punë të pavarur.

Gjithashtu u konstatua se kishte hapësira të mjaftueshme për stafin akademik por dhe atë administrativ, të pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për kryerjen e kërkimeve akademike, shkencore dhe të aplikuar.

Përveç klasave, ka dhe shumë ambiente rekreative për studentët të tilla si kafe, biblioteka, ambiente me Wi-Fi për Këshillin Studentor dhe klubet studentore, ambiente sportive etj.

Brenda Kompleksit Universitar gjendet Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit i cili përdoret për testimin, ekzaminimin e materialeve të ndryshme, përcaktimin e rezistencave dhe qëndrueshmërisë së materialeve, veçanërisht të betonit, testimin e elementeve të konstruksioneve etj. Ky laborator është një nga asetet më të rëndësishme të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Së bashku me përdorimin e lëndëve të ndryshme, studentët kanë mundësi të përdorin pajisje laboratorike për kërkime të ndryshme shkencore, individualisht ose në grupe. Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 283 m<sup>2</sup>.



### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

• Salla për leksione	752 m <sup>2</sup>
• Klasa për seminare	1,545 m <sup>2</sup>
• Salla për aktivitete promovuese	128 m <sup>2</sup>
• Salla për praktikë lëndore/ profesionale	258 m <sup>2</sup>
• Laboratorë për lëndët	233 m <sup>2</sup>
• Laboratorë informatike	174.60 m <sup>2</sup>
• Salla interneti	151.80 m <sup>2</sup>
• Salla për bibliotekë	322 m <sup>2</sup>
• Mjedis për fotokopjime, librari etj	85.20 m <sup>2</sup>
• Zyrë informacioni për studentët	71 m <sup>2</sup>
• Nyje hidrosanitare	327.2 m <sup>2</sup>

- Mjediset për stafin:

• Mjedise për Dekanin/ kancelarin	285.50 m <sup>2</sup>
• Zyra për sekretarinë mësimore	60.60 m <sup>2</sup>
• Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	328.50 m <sup>2</sup>
• Zyra për personelin akademik	620 m <sup>2</sup>

GVJ ka vërtetuar disa nga hapësirat e kampusit Universitar, përkatësisht objekteve me funksione të veçanta dhe se hapësirat e destinuar për studentet, Personelin Akademik, Administratën, Strukturat menaxhuese të Universitetit sigurojnë funksion të kënaqshëm dhe të pa penguar te IAL.

IAL ka zyrën e koordinimit të teknologjisë të informacionit dhe komunikimit e cila zyre siguron shërbime të informatizuar që i duhen Universitetit. Kjo zyrë planifikon infrastrukturën e sigurve të informatizuar të Universitetit dhe siguron vazhdimësinë e funksioneve të saj, punon për projektin e përdorimit efikas, ligjor, dhe përdorim të gjerë të shërbimeve informative për studentët dhe personelin.

Kjo zyrë ofron shërbime për studentin dhe personelin përkatësisht:

- Turnitin software- kontrollon mundësin e plagjiatit dhe zhvillon të kupton citimet e burimeve si pjesë e argumenteve akademike.
- Sistemi i Menaxhimit të Studimit (LMS) – Një shërbim i bazuar në Moodle që ofrohet për studentët, lektorët dhe tutorët për hyrë, koordinuar dhe organizuar online materialet e kursit.
- Sistem për Menaxhimin e Bibliotekës (Koha) - Koha është një Sistem i Integruar për menaxhimin e Bibliotekës me burim të hapur që përdoret sot nga qindra bibliotekë në të gjithë botën.
- Sistem për Arkivin Digjital (Dspace) – Arkiva digjitale institucionale e Universitetit “Epoka”: Dspace është një paketë softueri arkivues me burim të hapur që përdoret zakonisht për të krijuar arkiva të hapura që kanë përmbajtje shkollore digjitale.
- Webmail (Ilogari Google) – Universiteti “Epoka” përdor Google aplikacione për shërbime arsimimi dhe të gjithë studentët dhe stafi akademik kanë një adresë e-mail në domenin epoka.edu.al që është një Ilogari Google.



- Google classroom – Duke përdorur Google classroom, materialet e kursit mund të integrohen me shërbimet e tjera të Google ku përdoruesit e caktuar mund të bashkëpunojnë. Studentët, lektorët dhe tutorët mund të përdorin këtë shërbim duke përdorur llogarinë që ju është dhënë.
- Education Information System (Kurrikula) – një faqe interneti që përmban informacione për programet e studimit, kurrikulën dhe sillabusin e kursit.
- Karta e identifikimit Smart: të gjithë studentët dhe stafi disponojnë nga një kartë identifikimi Smart.
- Help Desk: Zyra është përgjegjëse edhe për mirëmbajtjen e kompjuterëve të stafit dhe laboratorëve si nga ana e softuer ashtu edhe për harduer.
- Mundësi softuerike Universiteti Epoka është abonuar Programin Microsoft që quhet DreamSpark.
- Mundësitë e Network-ut (rrjetit); Universiteti “Epoka” ka lidhje internet WI-FI wireless për të gjithë personat në kampus.

Biblioteka e Universitetit “Epoka” funksionon si pjesë integrale e institucionit. Shërbimi i bibliotekës jepet nga punonjës të caktuar nga institucioni dhe është e hapur për stafin akademik dhe studentët. Me kapacitetin e saj prej 100-vendëshe, biblioteka ka një sipërfaqe prej 400m<sup>2</sup>. Biblioteka Universitare përbëhet nga hyrja, salla e librit dhe salla e leximit.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arrijtjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka vendndodhje të përhershme ku ndodhet mjedisi qendror administrative dhe ku zhvillohet veprimtaria mësimore.</p> <p>Kampusi i Universitetit EPOKA është kompleks ndërtesash me funksione të ndara. Këto ndërtesa funksionojnë të pavarura nga njëra tjetra pa krijuar pengesa. Ndërsa GVJ vlerëson se hapësirat e Universitetit EPOKA ofrojnë mundësi komode dhe gjithëpërfshirëse për aktivitetet mësimore, ushtrime në laboratorë, Bibliotekë, hapësira administrative, restorante, terrene sportive etj..</p> <p>Kampusi është i lidhur me rrugën kryesore publike Tiranë-Rinas, në afërsi të Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës.</p> <p>Universiteti EPOKA ka në pronësi kampusin që shfrytëzohet për aktivitetet e Universitetit.</p>
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një</p>	<p>Biblioteka ka një literaturë të mjaftueshme por dhe të shumëllojshme, e cila i vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime, për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore por dhe përgatitjen e tezave të masterit dhe jo vetëm.</p> <p>Institucioni siguron një numër të konsiderueshëm të teksteve mësimore bazë dhe literaturës ndihmëse në ambientet e bibliotekës së Universitetit “Epoka”.</p> <p>Literatura gjendet në gjuhë të ndryshme si: shqip, anglisht, turqisht etj. Biblioteka pasurohet nga blerjet dhe donacionet që bëhen nga persona dhe kompani të ndryshme. Librat që blihen përzgjidhen sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik.</p>



<p>plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka ka botime periodike dhe libraritë elektronike të cilat përmbajnë libra ose revista shkencore që nevojiten për përfundimin e programit studimor, projektet e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e tezës. Universiteti Epoka është anëtar me të drejta të plota në bibliotekën elektronike JSTOR.</p> <p>Përgjegjësi i programit gjithnjë harton plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, duke përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim .</p> <p>Nga vizita në bibliotekë u konstatua se ndodheshin periodikë të ndryshëm të shkruar por dhe elektronikë të revistave me influencë shkencore por jo vetëm.</p> <p>Biblioteka ishte në dispozicion të studentëve gjatë gjithë ditës, madje ofronte shërbim edhe ditëve të veçanta në fundjavë. Biblioteka ishte e pajisur me hapësirat e nevojshme për punë të pavarur.</p> <p>Biblioteka është e hapur nga e hëna deri të premten nga ora 08:30-12:30 - 13:30-17:30, dhe të shtunën nga ora 09:00-13:30.</p> <p>Ky detaj është relativisht pengues për studentët e Msc në "Inxhinieri Ndërtimi" pasi përgjithësisht ata fillojnë mësim në orën 18:00 dhe përrjedhojë nuk kanë mundësi ta frekuentojnë bibliotekën gjatë orarit që ajo është e hapur. <i>Për këtë arsye sugjerohet që disa nga lëndët të zhvillohen të shtunën paradite në mënyrë që studentët të kenë akses në bibliotekë.</i></p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në kampusin Universitar ka identifikuar hapësirat e laboratorëve të Inxhinierisë së Ndërtimit, labororet e Informatikës.</p> <p>Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit ka pajisje të cilat sigurojnë që studenti të jetë në gjendje të eksperimentoj materiale të ndryshme ndërtimore, të përcaktoj rezistencat e tyre karakteristike, të ekzaminojë elemente strukturore në përkulje, analiza gjeomekanike si dhe testime tjera te nevojshme për përcaktimin e vlerave të ndryshme. Pajisjet ekzistuese në laboratorë mjaftojnë për studimet e nivelit BSc dhe për nivelin Master.</p> <p>Hapësirat e zhvillimit të mësimin janë të mjaftuara dhe cilësore dhe përmbajnë pajisje të domosdoshme dhe të avancuara për leksionet, ushtrimet si dhe zhvillimin e detyrave projektuese me studentë.</p> <p>Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit duhet të vazhdojë edhe me tutje në zgjerimin e gamës së eksperimentimeve, ekzaminimeve si dhe shqyrtimeve të elementeve të strukturave dhe pjesëve të strukturave.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në institucion konfirmoi shumë lehtë dhe qartë se infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin e Programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile,</p>	



është në përputhje me standardet e vendit dhe të BE-së.

Universiteti "Epoka" ka mjedise të mjaftueshme si: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, duke i ofruar kështu studentëve një ambient komod dhe të përshtatshëm për ndjekjen e aktivitetit akademik por edhe atij social.

Në dispozicion të studentëve ka auditorë, klasa, sallë konferencash, mjedise të përbashkëta ku studentët mund të punojnë por dhe ambiente sociale ku mund të kalojnë kohën e tyre.

Sistemi digjital i cili përdoret si nga stafi ashtu edhe nga studentët, është një sistem i cili ndihmon dhe faciliton të gjithë procesin në 360 gradë. Ky sistem është shumë i plotë dhe shumë efektiv.

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Grupi i vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës në Universitetin EPOKA kontaktoi stafin përkatës dhe u konsultua me dokumente të shkruara për të verifikuar burimet e financimit dhe menaxhimit të tyre, dhe se rezultoi se Universiteti EPOKA është financuar nga një sërë të ardhurash si: tarifat për dhe gjatë shkollimit, Grante për kërkim shkencor dhe kontratat, aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bari, rezidencat etj) dhe te tjera.

Informacioni financiar i paraqitur më poshtë prezanton burimet e financimit ose të hyrat e universitetit sipas kategorisë: tarifat për dhe gjatë shkollimit, Grante për kërkim shkencor dhe kontratat, aktivitetet tregtare etj në vlerë absolute dhe si % ndaj totalit të burimeve. Gjithashtu jep, përdorimin e burimeve financiare ose shpenzimet e kryera nga institucioni gjatë periudhës sipas kategorisë, paga, shpenzime dhe investime duke treguar edhe burimin e financimit të tyre. Raporti financiar vazhdon me llogaritjen e kostos për student dhe më tej me ndarjen e përdorimeve sipas veprimtarive kryesore të institucioneve akademike që janë shpenzime për veprimtarinë akademike, shpenzime për kërkim shkencor dhe shpenzime për veprimtarinë e administrimit.

Del qartë edhe nga tabelat RVB, se pjesa më e madhe e të ardhurave në institucion vijnë kryesisht nga tarifat e shkollimit që paguajnë studentët, por këto të ardhura vijnë gjithashtu edhe nga Grante për kërkim shkencor dhe kontratat dhe Aktivitete tregtare (mensa, kafe, bari, rezidencat etj)

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme për Universitetin Epoka për vitin 2017-2018 (shih aneksin, tabela 16):

• Grantet për kërkim	7.25%
• Konsulencat, shërbimet	0%
• Tarifat për dhe gjatë shkollimit	92.44%
• Sponsorizimet	0%
• Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	0%
• Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj	0%
• Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj)	0.3%

Për programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndertimit në gjashtë muajt e fundit të vitit 2018 (shih aneksin, tabela 18) të ardhurat financiare vijnë vetëm nga tarifat e studentëve

• Grantet për kërkim	0%
• Konsulencat, shërbimet	0%



- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 100%
- Sponsorizimet 0%
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 0%
- Donacionet, aktivitetet sigurose, fondacione etj 0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 0%

Shpenzimet nga të ardhurat (për studentët) dhe kosto e studimit për student për të gjitha vitet e studimit për programin e Inxhnierisë së ndërtimit ngahen si më poshtë. Janë marë në konsideratë vitet 2012-2018

- Paga 42%
- Shpenzime 35%
- Investime 23%

Shpenzimet nga të ardhurat (për studentët) dhe kosto e studimit për student për vit akademik në programin e studimit Inxhinieri Ndërtimi per vitin e fundit akademik 2017-2018.

- Paga 55%
- Shpenzime 32%
- Investime 13%

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Sipas Raportit të vlerësimit të brendshëm dhe duke u mbështetur në vizitën e institucionit "Turgut Ozal Education" sh.a çdo vit i nënshtrohet auditimit të jashtëm përse i përket situatës financiare dhe raporti i hollësishëm i cili gjendet pranë zyrës së Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education sh.a.</p> <p>Raporti përmban analizën e të dhënave të shpenzimeve dhe të ardhurave të kompanisë dhe institucionet pjesë të saj. Të gjitha të dhënat për të ardhurat (grantet, tarifat e shkollimit të studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Sipas RVB Raporti financiar hartohet çdo vit nga Drejtoria e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh. a. dhe arkivohet në këtë Drejtori. Me përmbylljen e raportit, të dhënat dhe analizat i dërgohen Universitetit "Epoka". Universiteti "Epoka" operon me buxhet të pavarur.</p> <p>Bazuar në raportin financiar zyrtar Turgut Ozal Education sh. a. kompania ka një bilanc vjetor pozitiv dhe stabilitet financiar që garanton progresin e institucionit.</p>



### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Grupi i vlerësimit konstatoi se Universiteti EPOKA ka një auditim të përvitshëm (të jashtëm) të situatës financiare. Gjithnjë hartohet një raport financiar në të cilin parashikohen kostot e programeve të studimit, të ardhurat dhe shpenzimet e tilla që të shërbejë në një reflektim të drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë akademike.

Pasqyrat financiare të hyrjeve në IAL vit pas viti tregojnë rritje. Kjo rritje është e konsiderueshme dhe krahasuar vitet 2012 dhe 2018 rritja është e dyfishuar, gjë që dëshmon se Institucioni ka qëndrueshmëri financiare vit pas viti.

Menaxhimi i të ardhurave financiare, rritja e zërave buxhetorë si fondet për pagat e stafit në rritje, për kërkimin shkencor në kuptimin e gjerë, përfshirë këtu edhe aktivitetet, botimet, anëtarësimet në rrjete ndërkombëtare apo investime, duke pas parasysh që rritja e kostos së shkollimit në disa raste të mos kompensohet me rritjen e tarifës, dëshmojnë për kujdesin e veçantë ndaj cilësisë dhe dimensionin e përgjegjshmërisë sociale.

## **6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion GVJ konstaton se: Në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit EPOKA, institucioni ka ngritur një njësi të qëndrueshme, strukturimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i së cilës përcaktohet qartë në dispozitat e Statutit dhe të Rregullores Bazë të Universitetit "Epoka". Direktiva "Për Vlerësimin Akademik dhe Përmirësimin e Cilësisë tek Universiteti "EPOKA" shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit EPOKA.

Çështjet akademike vlerësohen nëpërmjet anketimeve të kryera nga studentët dhe nga vizitat që përgjegjësi i departamentit kryen pranë pedagogëve të ndryshëm. Çështjet administrative vlerësohen nëpërmjet sistemit ISO 9001: 2008 mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, sistem ky shumë i rëndësishëm për vlerësimin e ceshjeve administrative brënda një universiteti.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit

Nga dokumentat e vënë në dispozicion dhe gjithashtu nga vizita në institucion u pa që në përfundim të cdo lënde, NJSBC / KPSC kryen anketime online lidhur me cilësinë e mësimdhënies. Ky pyetësor përbëhet nga 14 pyetje standarde për të gjitha lëndët e universitetit. Këto pyetësorë janë të detyrueshëm të plotësohen nga cdo student në mënyrë që të marrë vlerësimin përkatës. Lënda gjithashtu vlerësohet edhe nga kolegët nëpërmjet leksioneve të hapura. Këto të dhëna përpunohen dhe bëhen pjesë e raportit të brendshëm vjetor.

Rezultatet e anketave i dërgohen Zyrës së Rektorit nga Zyra e Regjistrimit. Rektori, pasi merr në shqyrtim rezultatet e anketave, ia kalon PCQA / KPSC<sup>1</sup>, i cili analizon të dhënat për çdo kurs dhe lektor dhe i jep rekomandimet Rektorit. Me anë të zhvillimit të takimeve, Rektori sigurohet që rekomandimet e PCQA / KPSC në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies zbatohen në nivele Fakulteti dhe Departamenti. KPSC harton këtë raport dhe e bën atë publik jo vetëm për universitetin por edhe për publikun.

<sup>1</sup> KPSC - Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë  
PCQA - Permanent Commission on Quality Assurance



Kontrolli i brendshëm i cilësisë

KPSC është një njësi e përhershme e pavarur, e cila nëpërmjet punës së saj në vlerësimin e cilësisë, synon krijimin dhe konsolidimin e cilësisë në Universitetin EPOKA. Njësia përbëhet nga 12 anëtarë, një ndër të cilët është përfaqësues i studentëve, një përfaqësues i ish studenteve dhe një përfaqësues i jashtëm. Është organ me karakter të përhershëm, këshillimor dhe vlerësues dhe ka autonomi operative dhe qasje në të gjitha të dhënat e institucionit.

Gjatë takimit me anëtarët e NjBSC u konstatua se kishte një ndarje të qartë të detyrave të anëtarëve të njësisë. Kjo ndikonte drejtpërdrejt në kontrollimin dhe përmirësimin e cilësisë.

Këtu mund të përmendim se një nga anëtarët ishte i angazhuar vetëm për menaxhimin e procesit të vlerësimit të mësimdhënies, ndersa një staf tjetër për monitorimin e proceseve administrative, kishte përfaqësues dhe përgjegjës për kontrollimin e procesit kërkimor shkencor etj. Të gjitha këto krijojnë një tablo të qartë dhe konkrete në fushën e cilësisë dhe përmirësimit të saj.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Është shumë me vlerë në përmirësimin e cilësisë, fakti që Universiteti "EPOKA" mori certifikatën ISO 9001: 2008 mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë. Aktualisht, Universiteti "EPOKA" ka ripërtërirë certifikatën, e cila sipas kritereve ISO kryhet çdo tre vjet. Auditimi i jashtëm i fundit i kryer në kuadër të ISO është mbajtur në mars 2014. Ky certifikim garanton edhe një herë cilësinë e universitetit jo vetëm në nivel akademik por edhe në atë administrativ. Auditimi i brendshëm është një tjetër mjet i përdorur nga institucioni për të garantuar cilësinë dhe rritjen e vazhdueshme të universitetit. Në shtojcën 9 (EMPLOYMENT AND PERFORMANCE ASSESSMENT OF THE ACADEMIC STAFF REGULATION) specifikohet sistemi i pikëzimit të kërkimit shkencor. Kjo është një vlerë e shtuar e institucionit, i cili nuk vlerëson vetëm procesin e mësimdhënies por edhe kërkimin shkencor dhe angazhimin e personelit akademik në projekte kërkimore dhe shkencore.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Univeriteti EPOKA ka pjesë së strategjisë së tij përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, dhe për këtë arsye mbi baza vjetore bëhet vlerësimi i ecurisë së programeve, nëpërmjet shqyrtimit të anketimeve të studentëve, mbarëvajtjes së procesit mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët, sugjerimeve prej pedagogëve të përfshirë në këtë program studimi etj. KPSC, nëpërmjet Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet komisioneve të tij, vlerëson periodikisht efikasitetin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve administrative të Universitetit.  Nga këto kontrolle hartohen raporte, janë prodhuar vlerësime, janë nxjerr rekomandime dhe janë lënë detyra për rregullsinë e procesit mësimor, si dhe janë propozuar masa për ndryshime apo korrigjime për raste ose çështje konkrete.  Informacioni i nevojshëm është përfshirë në raportin e vetëvlerësimit të institucionit i cili bëhet publik dhe dërgohet në
<b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	
<b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	
<b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.	
<b>Të tërthorta:</b> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista;	
<b>Të drejtpërdrejta:</b> a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të	



<p>standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p>	<p>ministrinë përkatëse.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit janë përdorur metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, ndjekja e ecurisë së studenteve, etj.</p> <p>Më konkretisht: Metodat e tërthorta të vlerësimit zbatohen nëpërmjet një ankete të zhvilluar me studentët, i cili ka rubrika të veçanta për:</p> <p>a) Pyetje mbi përmbajtjen e lëndëve</p> <p>b) Pyetje mbi performancën e instruktorit të lëndës</p> <p>c) Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga Universiteti “EPOKA”</p> <p>d) Pyetje konceptuale</p> <p>e) Rekomandimet nga studentët.</p>
---	--

**Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Universiteti “EPOKA” përgatit dhe shpërndan në formën e një broshure vlerësimet periodike mbi cilësinë. Këto broshura përmbajnë rezultate të anketave periodike të stafit dhe studentëve. Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të institucionit. Këto informacione bëhen publike rregullisht.</p> <p>Universiteti “EPOKA” publikon në faqen e internetit analizat dhe raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të të gjithë cikleve të studimeve. Ky raport dërgohet në MAS dhe ASCAL</p>
---	---

**Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile vlerësohet pas çdo semestri dhe në fund të çdo viti akademik bëhet një analizë vjetore. Ky proces është nën përgjegjësinë e NJBSC në bashkëpunim me dekanatin dhe departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit pranë Universitetit EPOKA.</p> <p>Procesi vlerësimit deri më sot mbështetet kryesisht në vlerësimin nga studentët. Vlerësimi nga eprorët kryhet në mënyrë rastësore nëpërmjet vizitave në klasë. <i>Sugjerohet që vlerësimi nga kolegu / eprori të bëhet në cdo lëndë dhe jo në mënyrë rastësore. Gjithashtu duhet marrë në konsideratë edhe vetë vlerësimi që cdo pedagog i bën vetes. Në këtë mënyrë do të kemi një pasqyrë më të plotë për vlerësimin e një lënde.</i></p> <p><i>Sistemi i vlerësimit për instruktorin nga ana e eprorit është përshkrimor dhe nga ana e studentëve është me sistem pikësimi. Sugjerohet të mbahet i njëjti sistem vlerësimi për të gjitha palët e përfshira.</i></p> <p>Gjetjet kryesore të raportit vjetor bëhen publike dhe diskutohen. Këto raporte janë pjesë e raporteve vjetore të aktivitetit të Universitetit. Raportet përgjegjëse përmbajnë edhe anketat e</p>
--	--



	<p>studentëve dhe raportet e brendshme të vlerësimit.</p> <p>PCQA/KPSC, vlerëson periodikisht efikasitetin e mësimdhënies në Universitet, kërkimit shkencor dhe aktivitetet administrative. Ai i vjen në ndihmë Departamenteve gjatë propozimit të kurrikulave të reja ose ndryshimit të tyre. Kjo asistencë e KPSC në përmirësimin e programeve të studimit, vjen si rezultat i Planit Strategjik të Universitetit "EPOKA", i cili zhvillon politika që kanë për synim përmirësimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Masat që merren për përmirësimin e një programi përfshijnë: konsultime me studentët dhe partnerët brenda dhe jashtë Universitetit, raportet e brendshme dhe të jashtme të vlerësimit, projektet e menaxhuara në kuadër të programit të Bashkimit Evropian "Erasmus Plus".</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedurën të caktuar për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Universiteti "EPOKA" ka përmbushur standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit. Ri-akreditimi institucional më i fundit i Universitetit "EPOKA" u krye në 2017 nga QAA (Agjencia Britanike/ASCAL). Rezultatet pohuan që Universiteti "EPOKA" përmbush standardet e kërkuara.</p> <p>Kjo dëshmon qartë dëshirën e madhe të institucionit për përmirësimin e cilësisë së ofruar.</p> <p>Cilësia sigurohet nga vlerësimi i vazhdueshëm, qoftë nga studentët qoftë nga stafi. Ky është instrumenti bazë i sigurimit të cilësisë. Vlerësimi bazohet jo vetëm në cilësinë e lëndës por edhe të shërbimeve të ofruara nga institucioni.</p> <p>Procedura e ndjekur për sigurimin e cilësisë dhe standardeve përfshin anketimin vlerësimin në fund të vitit akademik të stafit të angazhuar në mësim dhënie. KPSC harton politika dhe strategji për vlerësimet e mësipërme.</p> <p>Politikat e institucionit hartohen dhe mbikëqyren nga senati i Universitetit EPOKA. Ai bën zhvillimin e politikave të institucionit, programon, koordinon, orienton dhe kontrollon aktivitetet mësimore dhe të kërkimit shkencor dhe vlerëson efektivitetin e tyre, dhe merr vendime për probleme të rëndësishme të institucionit arsimor-shkencor. Rishikimi i programeve të studimit bëhet nga ky organ me propozim të KPSC.</p> <p>Stafi dhe studentët janë pjesë esenciale e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm, për të siguruar cilësinë e programeve të studimit. Për këtë qëllim, KPSC organizon edhe trajnime që kanë për qëllim të rritin ndërgjegjësimin për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Universiteti "EPOKA" ka zhvilluar dhe ka zbatuar një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si pjesë e Planit Strategjik të Universitetit "EPOKA" dhe si pjesë e planeve</p>



strategjike departamentale. Strategjia, politikat dhe procedurat publikohen në Planin Strategjik të institucionit dhe në planet strategjike të Departamenteve.

Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, Rektorat etj.


Përmirësimi i Cilësisë së programeve të studimit është themelor për misionin e Universitetit "EPOKA". Universiteti përdor të dhëna cilësore dhe sasiore për vlerësimin e lëndëve të tij, programeve të studimit dhe mësimdhënies, përfshirë reagimet e studentëve dhe partnerëve për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë aplikohet tek të gjitha programet e studimit të ofruara nga Universiteti.

Rishikimi i çdo programi studimi administrohet nga Departamenti përkatës, Fakulteti, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulës nën Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë dhe Senatit Akademik. Shtojca 19 Politika e Përmirësimit të Vazhdueshëm të Programit të Studimit.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

**Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimin me anëtarët e NJBSC/KPSC, stafin akademik si dhe në takimin me studentët u arrit në përfundimin se:**

1. NJBSC/KPSC ka një status institucional të mirëpërcaktuar si njësi permanente e mbështetur në anëtarë të brendshëm por dhe me përfaqësues nga studentët, nga ALUMNI dhe nga anëtarë që nuk janë pjesë e institucionit, kjo krijon një diversifikim dhe efikasitet në mënyrën se si operon në përmirësimin e cilësisë.
2. Kjo njësi operon në bazë të dispozitave të statutit të universitetit EPOKA. Ajo bazon aktivitetin e saj si një njësi me autonomi dhe përgjegjësi maksimale për të kryer aktivitetin e kontrollit, evidentuar problematikat dhe sugjeruar përmirësimet e nevojshme të cilat lidhen drejtpërdrejt me cilësinë.
3. Institucioni garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron. Universiteti "EPOKA" kryen një analizë vjetore vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë. Mbështetur në Planin Strategjik të Universitetit "EPOKA", Institucioni zhvillon politika që kanë për synim përmirësimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë. Për të realizuar këtë proces ka një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese.
4. Institucioni publikon rregullisht informacion te paanshëm dhe objektiv, sasior dhe cilësor për vlerësimin e brendshëm. E gjithë veprimtaria e institucionit në lidhje me cilësinë përputhet me vizionin dhe udhëhiqet nga objektivat e strategjisë.
5. Institucioni përdor instrumente të përshtatshme për sigurimin e cilësisë, përdor mekanizma formalë për rishikimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit,
6. Njësia ka për detyrë kryesore të monitorojë dhe raportojë në mënyrë të vazhdueshme rreth cilësisë së brendshme të institucionit.





## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion pas takimit GVJ konstaton se: Universiteti "EPOKA" është organizuar dhe vepron si një Universitet jo-publik, me karakter akademik dhe shkencor, që ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit.

Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit tek Universiteti "EPOKA" është pjesë përbërëse e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Programi i orientuar drejt kërkimit shkencor Master i Shkencave në Inxhinierinë e Ndërtimit, mbështet tek cikli i parë i studimeve në këtë fushë dhe ndihmon për studime më të avancuara në një nga profilet e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Qëllimi i këtij programi është që vazhdimisht të pajisë studentët me njohuri më të gjera dhe më të thella, me aftësi dhe qasje, që mundësojnë një funksionim më efektiv në mjedisin sfidues të dekadave të ardhshme të inxhinierisë së ndërtimit. Studentët e programit të studimit të Ciklit të Dytë pritet të jenë studjuesit dhe specialistët lider në këtë fushë.

Të diplomuarit në këtë program do të mund të punësohen në kompani konsulence, institucione shtetërore, sipërmarrje private, bashki dhe firma të tjera. Fushat specifike të punësimit për të diplomuarit e Institucionit të Arsimit të Lartë "Epoka" janë fushat e inxhinierisë, sondazhe topografike të kushteve ekzistuese, studime të vendeve dhe analizave strukturore, projektimi i strukturave të çelikta dhe strukturave të beton armesë, testimi i dheut dhe i materialeve të tjera si beton, asfalt, etj., si dhe supervizim ndërtimi.

Objektivat e programit: Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile, duke cituar RVB janë:

*Studentët e programit MSc duhet të kenë:*

- 1. Njohuri të parimeve inxhinierike, të mjaftueshme për të kuptuar bazën dhe aplikueshmërinë e analizës standarte, projektimin dhe praktikën e zbatimit, brenda fushës së tyre.*
- 2. Aftësi për të kryer analiza inxhinierike dhe për të bërë dhe zbatuar projekte dhe për të zgjidhur problem në përputhje me kodet e aplikuara dhe standartet e praktikës.*
- 3. Të kuptuarit e faktorëve të ndryshë teknikë dhe jo teknike që ndikojnë në fizibilitetin dhe zbatimin e projekteve të inxhinierisë së ndërtimit, përfshi: fizibilitetin teknik, përfshirjen shumëpalëshe, vlerësimin mjedisor, planifikimin financiar/ekonomik, administratën priate/të punëve publike, planet strategjike të pronarit dhe çështjet social-ekonomike dhe çështjet social-ekonomike/të barazisë.*
- 4. Themeli i nevojshëm për të zhvilluar mendimin inxhinierik përmes praktikës profesionale dhe për të identifikuar me efektivitet, shqyrtuar dhe përcaktuar objektivat e shumta dhe konkurruese. Kjo është një objektivë e programit, por në fakt nuk arrihet pasi praktika profesionale nuk është detyruese për studentët. Shumë prej tyre punojnë, por jo të gjithë. Duke mos e patur detyruese praktikën profesionale, studentët të cilët nuk janë në marrëdhënie pune dalin të pa përgatitur për tregun e punës pas përfundimit të programit.*
- 5. Njohuri teknike dhe aftësitë e duhura për të ndjekur të mësuarit gjatë gjithë jetës me aftësinë për të zgjeruar në mënyrë të pavarur njohuritë personale dhe të kuptuarit të temave dhe praktikave inxhinierike, duke kryer kërkime literature, duke u këshilluar me të tjerët, dhe duke përdorur teknika të tjera të ngjashme.*
- 6. Njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kaluar provimet e licensimit të specialitetit në fushat e tyre përkatëse. Ky është një objektivë shumë e mirë por jo për rastin shqiptar pasi licencimi në shqipëri nuk bëhet nëpërmjet një provimi por nëpërmjet dorëzimit të dosjeve me punët e kryera. Kjo e fundit mund të jetë një objektivë në të ardhmen.*



Ashtu siç e parashikon "Rregullorj për Programin e Studimit të Ciklit të Dytë", Shtojca 13, dhe Rregullorja Bazë (Shtojca 11)", programet janë të organizura sipas sistemit me kohë të plotë.

Programi përbëhet nga 120 kredite ECTS dhe 121 kredite ECTS, përkatësisht:

- a) "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit" – 121 kredite ECTS
- b) "Menaxhim i Ndërtimeve" – 121 kredite ECTS
- c) "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit" – 120 kredite ECTS
- d) "Inxhinieri e Resurseve Ujore" – 120 kredite ECTS

dhe kurrikula e tij propozohet nga departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, me vendim të Këshillit të Fakultetit dhe miratuar me vendim të Senatit Akademik të Universitetit Epoka.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Studimet në programin e Ciklit të Dytë janë me kohë të plotë. Mësimi për këtë program studimi zhvillohet mesatarisht 3 ditë në javë gjatë mbasditeve (nga ora 18:00 deri në 21:00). Kjo bëhet për të ndihmuar studentët që janë në marrdhënie pune.

Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë është dy vite akademike ose katër semestra.

Programi përbëhet nga 15 lëndë, një projekt semestral dhe një tezë, e cila përfundohet në fazën përfundimtare të programit të studimit të ciklit të dytë.

Kohëzgjatja maksimale e programeve të studimit të nivelit të dytë është tetë semestra. Nëse kjo periudhë kohore shtyhet për më shumë, Universiteti e ndërpret marrëdhënien e tij me studentin.

- 1 vit akademik ka përkatësisht 527 orë mësimi në auditor gjatë vitit të parë dhe 148 orë në auditor gjatë vitit të dytë
- 1 vit akademik ka 32 javë mësimi në auditor, përfshi javën e provimit përfundimtar
- 1 semestër ka përkatësisht orë në auditor:
  - 303 – semestri i parë
  - 224 – semestri i dytë
  - 48 – semestri i tretë
  - 100 – semestri i katërt
- 1 Semestër ka 16 leksione në auditor, përfshi javën e provimit përfundimtar
- 1 ECTS = 25 orë punë e studentit
- 1 orë mësimi është 60'

Studenti që përfundon me sukses të gjitha lëndët me kredite dhe temën e diplomës, dhe që ka grumbulluar 120 kredite ECTS, ose 121 ECTS, i jepet diploma përkatëse. Me Urdhër Nr.565, datë 2011-11-22 "Për regjistrimit e formës së diplomave të Universitetit "EPOKA"", titulli i diplomës është: Diplomë e ciklit të dytë "Master i shkencave", me forme studimi me kohë të plotë, në "Inxhinieri ndërtimi, me profilet:

- a) Inxhinieri e strukturave;
- b) Menaxhim i ndërtimeve;

Diploma shoqërohet me Supplementin e diplomës, përmbajtja dhe forma e të cilës hartohet nga Senati në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit. Supplementi i diplomës përmban natyrën dhe nivelin e studimit, përmbajtjen e tij, rezultatet e studentit dhe rregulloret e tjera të përcaktuara nga Senati i Universitetit në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksione 400 orë në auditor dhe 838 orë punë e pavarur e studentit
- Për seminarët 112 orë në auditor dhe 135.5 orë punë e pavarur e studentit



• Për laboratorët	25 orë në auditor dhe	25 orë punë e pavarur e studentit
• Për praktikën e lëndës	48 orë në auditor dhe	92 orë punë e pavarur e studentit
• Për praktikën profesionale	0 orë në auditor dhe	0 orë punë e pavarur e studentit
• Provimi përfundimtar	48 orë në auditor dhe	750 orë punë e pavarur e studentit;

Praktika profesionale është një element që mungon në kurrikulën e programit të studimit. Nga analiza e kryer rezulton që lënda "Term Project" ka 10 ECTS dhe studenti kryen 50 orë në laborator dhe 200 orë pune të pavarur praktike (këto orë janë nën kategorinë practice dhe independent work Tabelat 23, 24, 25, ne Aneks). Në pamje të parë duket sikur kjo është praktika profesionale por në vetvete syllabusi i lëndës nuk përfshin asgjë lidhur me praktikën profesionale. Sygjerohet të rishikohet shpërndarja e orëve për këtë lëndë ose të rishikohet syllabusi i lëndës. Nga rishikimi i dokumentacionit të dorëzuar vërehet që mungon praktika profesionale, gjë që është e detyrueshme për këtë kategori studimesh. Praktika profesionale duhet të bëhet e detyrueshme për të gjithë studentët pasi jo të gjithë janë në marrëdhie pune dhe praktika profesionale i ndihmon ata të jenë të përgatitur kur të dalin në tregun real të punës.

Analizë e Kurrikulës së programit të studimit (Tabelat 23, 24, 25, ne Aneks)

Masteri i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi i jep studentëve mundësinë për t'u specializuar në katër profile si: *Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit*, *Menaxhim i Ndërtimeve*, *Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit* dhe *Inxhinieri e Resurseve Ujore*. Ai kombinon kurrikulën bazë me mundësinë për të marrë lëndë me zgjedhje, sipas fushave me interes për studentët.

Këto lëndë zakonisht kanë lidhje me temën e tezës dhe studenti zgjedh, duke u këshilluar me këshilltarin e departamentit. Studentët, për të fituar diplomën MSc duhet të plotësojnë gjithsej 120 kredite ECTS (ose 121 kredite ECTS).

Një problematikë e konstatuar në të katër profilet e studimit është mundësia e zgjedhjes së lëndëve në kategorinë B. Të gjitha lëndët që vendosen nën këtë kategori janë shumë të rëndësishme dhe nuk duhet të jenë me zgjedhje por të detyrueshme, po ashtu edhe në kategorinë A dhe C. Ndarja në kategorinë D, E dhe F është e saktë. *Rekomandohet të hiqet termi "Technical Elective" dhe të vendoset emri i lëndës konkrete që duhet ndjekur nga studenti. Nga vizita në institucion u pa që në 90% të rasteve aktivizohen të njëjtat kurse cdo vit, për rrjedhojë këto janë lëndët që studentët zgjedhin, dhe duhet të kenë emrin e tyre lëndët përkatëse.*

Nga vizita në institucion u pa që lënda "Fundamentals of Steel Design" 7 ECTS zhvillohet nga të gjithë profilet megjithëse ajo futet diku në kategorinë B dhe diku në kategorinë D. Rekomandohet të rishikohet dhe lënda në fjalë të jetë kudo e detyrueshme për sa kohë kjo ndodh në të vërtetë.

Koment për Profilin "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit" dhe "Menaxhim i Ndërtimeve"

- Vërehet që një nga lëndët e detyrueshme është "Fundamentals of Steel Design" për të dy profilet. Nga vizita në institucion dhe nga takimi me studentët na u tha që kjo lëndë është e tepërt dhe jo shumë e nevojshme për profilin "Menaxhim i ndërtimit". *Rekomandohet që për këtë program studimi mos të jetë kjo lëndë e detyrueshme, por një nga lëndët që ka të bëjë me menaxhimin e ndërtimit. Lënda në fjalë është shumë projektuale.*

Gjatë analizës së dokumentacionit të dorëzuar rezulton janë vetëm 13 lëndë në total, vetëm 7 janë të detyrueshme dhe të tjerat janë Lëndë me zgjedhje. Kjo ndikon direkt në peshën që lëndet me zgjedhje duhet të kenë brenda një programi. Lëndët e detyrueshme sipas profileve janë:

- Special Topics in Civil Engineering
- Supervised Group Study and Research
- Special Studies in Civil Engineering
- Supervised Independent Study and Research



- Term Project
- Master Thesis
- Water Resource Engineering I (Inxhinieri e Resurseve Ujore)
- Properties of Fresh and Hardened Concrete (Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit)
- Fundamentals of Steel Design (për profilin Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit dhe Menaxhim i Ndërtimeve)

Vërehet që baza teorike e detyrueshme është relativisht e ulët, është vetëm një lëndë teorike e detyrueshme për profil, 6 lëndët e tjera nuk janë mirfilli teorike ato kanë një karakter më shumë aplikativ dhe projektues.

Nga këto 6 lëndë një është tema e diplomës dhe një "term projekt", kjo e ul akoma më shumë numrin e lëndëve të detyrueshme. Lëndët e tjera teorike janë nën kategorinë "*Technical Elective*". Për rrjedhojë lëndet me zgjedhje përbëjnë 50 ECTS (42% të krediteve totale), Ky fakt duhet rishikuar pasi i bën studentët shumë të ndryshëm nga njëri tjetri në nivel përgatitjeje teorike. Vërehet që lënda "*Mbikqyrja e Grupit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor*" është gjithashtu relativisht e pavarur si lëndë, kjo rrit numrin e ndryshimeve nga njëri student tek tjetri.

Nga vizita në institucion dhe nga rishikimi i dokumentacionit u pa që studentët vit pas viti ndjekin të njëjtat lëndë, qofshin këto me zgjedhje ose jo. Kjo do të thotë që nëse lëndët, edhe pse janë "*Technical Elective*", "zgjidhen" cdo vitë nga studentët, këto lëndë duhet të bëhen të detyrueshme dhe mos të jenë më në kategorinë "*Technical Elective*".

Parimi i institucionit për ta bërë sa më dinamik programin e studimit është për t'u vlerësuar, por gjithë ky dinamizëm mund të sjellë studentë me përgatitje shumë të ndryshme, megjithëse kanë studiuar të njëjtin program studimi në të njëjtën shkollë.

Nga vizita në institucion dhe nga takimi me studentët na u tha që studentët zhvillojnë mësim vetëm 3 herë në javë nga 3 orë mbasditë. Në parim kjo mund të funksionojë, por në praktikë studentët punojnë dhe koha për të bërë kërkim shkencor është mjaft e kufizuar. Disa nga studentët u ankuan pasi shpesh herë e kishin të pamundur të ndjekin një klasë të caktuar për shkak se vijnë nga rrethet dhe mësimi zhvillohet vonë.

Nga një analizë e orëve në auditor, (në RVB është deklaruar 303 orë në auditor për semestër, e pjestuar kjo me 15 javë që ka një semestër), rezulton që studentët duhet të zhvillojnë 20.2 orë në javë. Kjo është e pamundur nëse mësimi zhvillohet vetëm 3 orë mbasditë /për 3 ditë në javë. Për këtë arsye, që të rritet shfrytëzimi i bibliotekës dhe laboratorit, dhe të realizohen orët e planifikuara rekomandohet që të zhvillohet mësimi edhe në fundjavë. Kjo duhet rishikuar pasi është një problematikë e madhe.

Literatura që përdoret nga Mësimdhënësit dhe ju përcillet Studentëve është Literaturë e re dhe bashkëkohore. Studentët kanë mundësi të qasjes në Bibliotekën e Fakultetit ku janë të siguruar shumë tituj - libra profesionale në gjuhën shqipe dhe të huaj (kryesisht Anglisht), si dhe mundësi të aksesit në e-library të Evropës.

Laboratori gjithashtu është një vlerë e shtuar e programit të studimit dhe institucionit. Por për shkak të orarit të limituar, ky laborator përdoret shumë pak nga studentët e programit të studimit Master i shkencave në Inxhinieri ndërtimi. Ky element duhet rishikuar duke shtuar orët e detyrueshme në laborator.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Në vitin 2014, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit propozoi hapjen e dy profileve të reja: "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit". Senati i Universitetit miratoi hapjen e këtyre dy profileve me Vendimin nr. 3, datë 10.12.2014. Këto dy programe u bënë të aksesueshme nga studentët vetëm në Mars të vitit 2018. Për rrjedhojë këto dy programe akoma nuk janë aktivizuar me studentë. Parashikohet që do të ketë rreth 4 student të regjistruar këtë vit akademik



Në vitin 2015, me propozim të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit, u shtua si lëndë me zgjedhje lënda "Materiale Çimentimi Shtesë". Ky ndryshim u miratua nga Senati.

Personeli Akademik ka një profilizim sipas disiplinave. Për mësimdhënien e leksioneve, seminareve, ushtrimeve, studio-ve janë pedagogë me formim profesional dhe shkencor me grada Doktor deri te Profesor i Asociuar Doktor.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Struktura e cdo syllabusi është përmbajtjesore dhe ato pasqyrojnë elementet e nevojshme, duke filluar nga titullari i lëndës, përshkrimi i përgjithshëm i lëndës, objektivat e lëndës të cilat të detajuara për secilën lëndë janë nën ombrellën e objektivave të përgjithshme të profilit. Syllabuset përmbajnë brenda vetes edhe rezultatet e nxënies ose kompetencave për studentin. Ky i fundit është një element shtesë mjaft i nevojshëm brenda një syllabusi.

Syllabuset e lëndëve kanë në strukturën e vet edhe mjetet didaktike. Në dosjen e vetëvlerësimit, syllabuseve u mungonte përshkrimi i lëndëve si dhe literaturën e detyruar dhe rekomanduar, ky element u kërkuar të plotësohej nga institucioni dhe syllabuset e plotësuara u morën gjatë vizitës në institucion.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Për secilën lëndë mësimore të programit të studimit, syllabuset ju prezantohen studentëve në fillim të semestrave përkatëse. Nga vizita në institucion u verifikuan të gjitha syllabuset e lëndëve për programin e studimit dhe konstatohet se janë në përputhje me standardet.

Nga analiza e cilësisë së syllabuseve rezulton se ato janë në përputhje me kërkesat e programit të studimit, gjykuar nga përmbajtja e tyre, përkatësisht nga specifikat e veçanta (pesha e tyre, orët, kreditë ECTS, kërkesat për studentin), njohurit e nevojshme e të domosdoshme që e përgatisin studentin.

Në dokumentacionin e dorëzuar gjënden 44 syllabuse. Nga analiza e tyre rezulton që tek disa nga syllabuset mungon përshkrimi i lëndës. Ky informacion gjendet më vete në shtojcën "course descriptions". Është për tu vlerësuar përfshirja në syllabus e kontributit që jep secila lëndë.

Transferimet e studentëve në programin Master i Shkencave

Gjatë vizitës në institucion por edhe nga dokumentacioni i dorëzuar, lidhur me transferimin e studentëve nga një program Master Profesional në "Inxhinieri Ndërtimi" në programin "Master i Shkencave" në Inxhinieri Ndërtimi, u konstatua që studentit i njiheshin 47 kredite nga 60 kredite që ky program ka<sup>2</sup>. Praktikisht studentit nuk i njihet vetëm mikro teza e masterit dhe i ulet një kredit nga lënda Fundamentals of Steel design, ku nga 8 kredite në programin Master profesional bëhen 7 kredite në programin Master i Shkencave.

Nga ky fakt dalim në konkluzionin që programi Master Profesional është viti i parë i programit Master i Shkencave.

Mendojmë se edhe pse lëndët mund të jenë me të njëjtin titull, trajtimi që bëhet në një master profesional është më aplikativ dhe më bazik se ai që bëhet në një Master i shkencave. Kjo do të thotë që lëndët nuk mund të njihen 100%. Gjithashtu është edhe çështja e mesatares së studentëve në regjistrim: hyrja në Masterin e Shkencave kërkon një mesatare më të lartë se hyrja në programin master profesional, kjo e specifikuar në rregulloren e programit të studimit. Duke bërë procesin e transferimit studenti nuk e respekton këtë kriter. *Rekomandohet* që mos të ketë njohje të plotë lëndësh dhe kreditesh, pasi programi master profesional do të konsiderohet si urë kalimi për në programin Master i Shkencave për studentët që

<sup>2</sup> U konstatua një dosje me gabime transferimi, në të cilën ishin njohur 57 kredite nga 60. Ky problem u rregullua dhe na u dorëzuar versioni i saktë i transferimit



nuk e arrijnë mesataren në hyrje. Hyrja në në programin Master Profesional është me mesatare mbi 2 ndërsa në programin Master i Shkencave është me mesatare mbi 2.5. Sistemi i transferimit nga njëri në tjetrin hedh poshtë kriterin e mesatares.

Diplomimi i studentëve në programin e studimit

Procesi i diplomimit për programin Master i Shkencave me profile në Inxhinieri Ndërtimi, fillon paraprakisht që në semestër të parë të vitit të dytë nën lëndën Term Project. Më tej ky proces finalizohet me lëndën Master Thesis. Studentët kryenin një diskutim me profesorin përkatës dhe më pas zgjidhnin temën që donin të studionin.

Një element që duhet përmirësuar lidhur me procesin e diplomimit është shpallja e fushave të temave të diplomave nga ana e departamentit dhe gjithashtu krijimi i kontrolleve të detyrueshme gjatë semestrit të katërt nga së paku 3 profesorë. Kjo do të ndihmojë shumë cilësinë e diplomave, mos përplasjen me tema të tjera dhe mendimi kritik nga më shumë se një profesor. Gjatë vizitës në institucion u pa që ka patur punime shkencore të kthyer mbrapsht. Kjo procedurë e propozuar do ta shmangte këtë gjë pasi studenti do të ishte futur në "filtër" përpara prezantimit final. Gjithashtu një element që duhet përmirësuar është edhe formati i diplomës.<sup>3</sup>

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u kërkua shpërndarja e lëndëve në tipe veprimtarie, numri i studentëve që ndjekin secilin program, rishikim i syllabuseve. Të gjitha këto dokumenta na u vunë në dispozicion nga departamenti i Inxhinierisë së ndërtimit.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Ky program studimi i ciklit të dytë konsiderohet si vazhdim i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i cili jep formim më të gjerë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit. Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është zhvilluar në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Programi i studimit për MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile, me nga 60 ECTS për çdo vit akademik plotëson kriteret e organizimit dhe grumbullimit të kredive brënda kornizës ligjore e cila parashikon një minimum prej 120 kredite ECTS.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi arrin që nëpërmjet lëndëve të përgjithshme, profesionale, lëndëve me zgjedhje dhe atyre formuese, të krijoj një kuadër profesional me kompetenca më të thelluara në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit.</p>

<sup>3</sup> Në kapak të diplomës është shkruar "partially fulfilled" edhe pse kjo është një temë diplome e dorëzuar dhe e mbrojtur. Gjithashtu në disa diploma mungon abstrakti në shqip, të gjithë studentët në abstrakt kishin vendosur emrin dhe udhëheqësin. Modeli i diplomave të fakultetit tjetër të universitetit Epoka ishte model shumë i mirë për tu ndjekur edhe për këtë program studimi.



<p>shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master shkencor” kanë objektiva të qarta profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Me kompetencat e fituara pas diplomimit studenti mund të vazhdojë në tregun e punës ose edhe në studimet e mëtejme më të thelluara. Duke qenë të qarta objektivat e përgjithshme të programit si dhe objektivat më të detajuara të lëndëve të programit të cilat kanë target tregun e punës në nivelin lokal dhe ndërkombëtar, ato sigurojnë edhe mundësin e studimeve dhe njohurive tjera shtesë.</p> <p>Kjo shprehet tek rregulloret e ciklit të parë dhe të dytë të studimit dhe objektivat e planit mësimor.</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në Inxhinierinë e Ndërtimit krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë dmth doktoraturë në Inxhinieri Ndërtimi</p> <p>Ky program ka objektiva të qarta profesionale dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Rekomandohet të rritet pesha e lëndëve lëndëve teorike dhe praktika profesionale</p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja e lëndëve, programi i studimit, lëndët me syllabuset e tyre synojnë arritjen e qëllimeve të përgjithshme të programit të studimit.</p> <p>Prandaj programi i studimeve parashikon aktivitete kërkimore koherente me projekte të veçanta përmes lëndëve të vecanta si Mbikqyrja e Grupit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor dhe Tema të Veçanta në Inxhinieri Ndërtimi.</p> <p>Shumë qartë vërehen objektivat e përgjithshme të cilat arrihen përmes organizimit të mësimit nëpërmjet leksioneve, punëve në grup ose individuale, ushtrimeve, etj.</p> <p>Metodat e vlerësimit jepen qartë në syllabusin e çdo lënde mësimore, ndërsa çdo pedagog organizon vlerësim me përqindje të ndryshme për këto rubrika.</p> <p>Metodat e vlerësimit të identifikuar gjatë vizitës në institucion vlerësohen si shumë bashkëkohore, sistematike, uniforme pa ngarkesa të panevojshme për studentin.</p> <p>Të gjitha metodat e vlerësimit janë të saktësuara në syllabuset e lëndëve dhe të cilat respektohen në pjesë me të madhe të rasteve. <i>Një element që rekomandohet të respektohet është sistemi i vlerësimit.</i></p>



	<p><i>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore në institucion u konstatua që e njëjta lëndë në të njëjtin vit kishte patur dy sisteme të ndryshme vlerësimi nga pedagogë të ndryshëm: njëra me sistem me notë (AA; AB, etj) tjetra me sistem kalueshëm ose jo kalueshëm (S dhe U). Ky element duhet të rregullohet dhe të përdoret i njëjti sistem vlerësimi sic është deklaruar në syllabus</i></p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Bashkëpunimi i Universitetit EPOKA me vendet ndërkombëtare është njëra nga objektivat e përgjithshme të institucionit. Qëllimi kryesor është që pas përfundimit të studimeve, studenti të jetë i gatshëm për tregun e punës në vend dhe jashtë tij. Kjo arrihet falë edhe bashkëpunimeve dhe projekteve të ndryshme për rritje kapacitetesh që universiteti Epoka është pjesë si partner.</p> <p>Në hartimin e kurrikulave (planit mësimor), stafi i angazhuar kanë ndarë përvojën personale të tyre tek universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit dhe kanë studiuar dhe analizuar edhe kurrikula të universiteteve të tjera me përvojë të gjatë në këtë fushë, duke i përshtatur me kushtet e tregut të punës në Shqipëri. Këtu duhet treguar kujdes me kontekstin lokal ku studenti nuk është i përgatitur të kryej punë kërkimore i pavarur. Prandaj rekomandohet shtimi i orëve në auditor.</p> <p>Ky program studimi zhvillohet sipas sistemit të Bolonjës, kurrikula përshtatet lehtësisht me atë të shkollave Europiane, mobiliteti i studentëve, transferimi i studimeve mund të realizohet me lehtësi duke marr parasysh lëndët, përmbajtjet e tyre, kreditë e tyre, metodat e vlerësimit.</p> <p>Objektivat e përgjithshme përkojnë me objektivat e përcaktuara me ligjet dhe udhëzimet e MAS si dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.</p>
<p><b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Fakti që një pjesë e madhe e studentëve janë në marrëdhënie pune në firma inxhinierike bën që ata të kenë qasje direkte me praktikën dhe me tregun e punës. <i>Por disa nga studentët nuk janë në marrëdhënie pune prandaj duhet siguruar praktikë profesionale për ta. Gjithashtu laboratorit i inxhinierisë së ndërtimit ishte një nga elementët më të rëndësishëm që e bëjnë këtë program studimi shumë konkurrues në treg. Ky laborator rrit akoma më shumë nivelin praktik të lëndëve prandaj i duhet kushtuar më shumë vëmendje.</i></p> <p>Finalizimi i këtij programi studimi kryhet nëpërmjet teze diplome e cila ka pjesë të saj kërkimin shkencor dhe aspektin praktik.</p> <p>Universiteti EPOKA është Institucion privat i Arsimit të Lartë i cili është i njohur për përcaktimin e fushave të studimeve të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, prandaj edhe Objektivat e përgjithshme të Universitetit dalin shumë të qarta.</p> <p>Personeli Akademik i punësuar në Institucion është i motivuar për bashkëpunim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Universiteti EPOKA është kreativ dhe pjesëmarrës në shumë konferenca dhe</p>



	<p>projekte ndërkombëtare në të cilat personeli Akademik ka mundësi reale për pjesëmarrje, prezantim të punimeve shkencore, shkëmbim përvojash akademike, etj. Një element për tu vlerësuar është edhe motivimi që institucioni ju bën kërkesve shkencorë. EPOKA motivon financiarisht personelin akademik për tu ritur profesionalisht në aspektin kërkimor shkencor. Edhe shumë prurje të personelit Akademik nga jashtë në Institucion janë tregues i synimit të realizimit të objektivave të programit. Puna kërkimore shkencore e stafit akademik të angazhuar në realizimin e programit të studimit përkon me objektivat e përgjithshme të e Universitetit “Epoka” dhe gjithashtu me objektivat e programit të studimit.</p> <p><i>Brënda programit duhet ulur pesha e lendeve me zgjedhje dhe te rritet pesha e lendeve karakterizuese / te detyrueshme. Gjithashtu praktikës profesionale i duhet kushtuar më shumë vëmendje pasi është një element që mungon dhe duhet shtuar në kurrikul.</i></p> <p><i>Kompetencat e studentit janë të thelluara në aspektin teorik, por ato duhet të thellohen akoma më shumë në aspektin profesional si dhe praktik duke shtuar orët laboratorike dhe duke e bërë praktikën profesionale të detyrueshme. Gjithashtu rekomandohet shtimi i lëndëve teorike të detyrueshme pasi është një program Master i Shkencave.</i></p> <p><i>Gjithashtu programi i studimit zhvillon një sasi të ulët orësh në auditor, rreth 9 orë në javë. Kjo është shumë pak për nivelin e studimit Masteri i Shkencave</i></p>
--	---

**Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Shkencor” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Vlerësuar nga përmbajtja e programit të studimit për nivelin Master i Shkencave, përmbajtjes së lëndëve, aktiviteteve mësimore, objektivave të arritura pas diplomimit të studentit, themi se ky grup studentësh mund ti ofrohet tregut vëndas dhe rajonal.</p> <p>Universiteti “EPOKA”, në hapjen dhe organizimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve, është mbështetur në nevojat e tregut. Ato janë vijimësi e programeve të ciklit të parë, të hapura me të njëjtën arsyetim.</p> <p>Kompetencat pas përfundimit të studimeve i bëjnë studentët të gatshëm të punojnë në një gamë të gjërë punësh si publike ashtu edhe private. Kjo falë edhe licencimit që ministria ju bën studentëve të programit Master i Shkencave.</p>
---	--

**Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> </ol>	<p>Ky program studimi i ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile jep mundësinë për të hyrë në tregun e punës. Universiteti “EPOKA”, i ka zhvilluar këto programe pas analizimit të nevojave të tregut dhe në përputhje me qëllimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar. Universiteti “EPOKA” ka realizuar një studim mbi nevojat e tregut të punës në lidhje me programet që ofron, dhe ia paraqiti për licencimin tek MAS dhe</p>
---	--



<p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>ASCAL.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Ky program Studimi në Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti "EPOKA" ndihmojnë për ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare, por mbartin edhe qëllimin kryesor të shtimit të numrit të studentëve të huaj për të promovuar kulturën dhe traditat shqiptare dhe më tej.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi e studimit "Master i Shkencave" në Inxhinierinë e Ndërtimit ka kohëzgjatje normale prej 2 (dy) vite akademike.</p> <p>Ai realizohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- me 120 kredite ECTS (profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit" dhe "Menaxhim i Ndërtimeve"</li> <li>- me 121 kredite ECTS (profilet "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit" dhe "Inxhinieri e Resurseve Ujore"</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Për secilin semestër janë të shpërndara nga 30 ECTS në mënyrë konstante.</p> <p>Teza e masterit në semestrin e katërt, ka 30 ECTS.</p>
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Secili student i regjistruar në Universitetin EPOKA, ka informacionet paraprake për përmbajtjen e programit të studimit, klasifikimin e lëndëve, syllabuset e tyre përmes formave elektronike në faqen web të universitetit si dhe takimet direkte me studentet.</p> <p>Syllabuset e lëndëve ekzistojnë në formë elektronike si dhe në formë të shkruar në arkivin e shkollës. Secili syllabus përmban informatat e përgjithshme dhe të veçanta për secilën lëndë. Syllabusi i çdo lënde publikohet tek faqja e internetit e Universitetit "EPOKA". <a href="http://eis.epoka.edu.al/">http://eis.epoka.edu.al/</a></p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë</p>	<p>Plani i diplomimit në programin Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi është me një program të qartë të shkruar në rregulloren e studimeve. Pas përfundimit të lëndëve mësimore në vitin e parë, në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve punohen tezat diplomave</p>




<p>parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>brënda lëndës “Teza e masterit”.</p> <p>Institucioni ka të përgatitur formën teknike të diplomës si dhe suplementin e diplomës për secilin. Rregullorja e Programit “Master i Shkencave” në Inxhinierinë e Ndërtimit shpjegon mënyrën e diplomimit të studentëve brenda afatit të parashikuar. Në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve, studenti duhet ta dorëzojë projektin e diplomës përpara se të përfundojë semestri.</p> <p>Procedura e ndjekur është si vijon: me propozimin e Departamenti ia dërgon Fakultetit propozimin për diplomimin e studentit që plotëson të gjithë kriteret e diplomimit. Fakulteti e dërgon propozimin e diplomimit tek Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm dhe në Rektorat për të marrë miratimin përfundimtar.</p> <p><i>Një element që duhet përmirësuar lidhur me procesin e diplomimit është shpallja e fushave të temave të diplomave nga ana e departamentit dhe gjithashtu krijimi i kontrolleve të detyrueshme gjatë semestrit të katërt nga së paku 3 profesorë. Kjo do të ndihmojë shumë cilësinë e diplomave, mos përplasjen me tema të tjera dhe mendimi kritik nga më shumë se një profesor ndihmon në rritjen e cilësisë së temave.</i></p>
--	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimin me anëtarët e departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit, stafin akademik si dhe në takimin me studentët u arrit në përfundimin se:

1. GVJ vlerëson se Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile është përmbajtësor, me një organizim të mirë të personelit të angazhuar në Institucion. Ky program studimi është i studiuar dhe i projektuar në mënyrë që të sigurojë një student / profesionist të përgatitur në aspektin teorik dhe cilësi profesionale për tregun e punës në vend dhe Europë.
2. Përmbajtja e programit të studimit shkon për shtat me kërkesat aktuale të tregut të punës.
3. Programi “Master i Shkencave” i ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka për qëllim të zgjerojë dijet e përfutuara në ciklin e parë të studimit, i cili u jep studentëve aftësi të përgjithshme dhe profesionale që duhet të realizohen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij.
4. Programi është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në planin strategjik për arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, me synim shtimin e numrit të studentëve të huaj për të promovuar edhe jashtë kulturën dhe traditat shqiptare, i ofruar në përputhje me nivelin e studimeve, dhe me qëllim që të arrihen dimensione ndërkombëtare, duke përfshirë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor, duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës.
5. Program i Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me kohëzgjatje 2 vjeçare përmban 13 lëndë me 120 kredite ECTS ose me 121 ECTS
6. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Diplomë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile, nëse plotësojnë së paku 120 kredite sipas sistemit ECTS. Diplomimi i studentëve parashikon zhvillimin e një lënde “Teza e masterit”. Kjo lëndë i përgatit studentët për procesin e diplomimit dhe kryhet në trajtën e një studioje me një grup pedagogësh.
7. Informacioni lidhur me programin e studimit ju jepet studentëve paraprakisht nëpërmjet konsultimeve me zyrën e regjistrimeve dhe me pedagogët përkatës. Gjithashtu ky informacion është i disponueshëm paraprakisht edhe në ëbsite
8. Shtrirja e Programit në 4 semestra ka kuptim duke vlerësuar planin mësimor dhe gjatë rrugëtimit



të studimeve, studenti përmbush kompetencat (rezultatet e nxënies) në mënyrë graduale dhe pa qenë shumë i ngarkuar që do të thotë se studimi është gradual deri në finalizim me punimin e tezave kur studenti fiton 120 ECTS dhe mund të ushtrojë kompetencat e fituara në tregun e punës.

9. Programi i studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi është në përputhje të plotë me standardet dhe kriteret e kërkuara nga aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë.

Elementë që duhen përmirësuar:

1. Programi i studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile nuk ka të parashikuar praktikë profesionale
2. Programi i studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile ka mbi 50% të lëndëve me zgjedhje (Studentët mund të zgjedhin edhe në grupin e lëndëve karakterizuese të cilat janë baza e një programi studimi)
3. Programi i studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile shpesh here kryen të njëjtat lëndë me programin e studimit MP në Inxhinieri Ndërtimi
4. Vërehet që zhvillohen pak orë në auditor (sipas orarit mësimor)
5. Vërehet një shpërndarje jo shumë korrekte e lëndëve në tipe veprimtarie
6. Vërehen probleme me formatin e diplomës dhe mungesë e një plani diplomimi.

Rekomandime:

1. *Rekomandohet që brënda programit duhet ulur pesha e lendeve me zgjedhje dhe te rritet pesha e lendeve të detyrueshme. Për këtë rekomandohet bërja e detyrueshme e lëndëve karakterizuese të profileve pasi ato janë shumë të rëndësishme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm në këtë fushë*
2. *Rekomandohet shtimi i praktikës profesionale dhe shtimi i orëve në laborator.*
3. *Rekomandohet zhvillimi i orëve në auditor në sasinë e planifikuar në kurrikul. Kjo do t'i bëjë studentët të përthithin më mirë informacionin e dhënë dhe do të kenë mundësi të shfrytëzojnë asetet e shkollës si biblioteka dhe laboratorin pasi ky laborator është një vlerë e shtuar për Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë por mbi të gjitha për departamentin e Inxhinierisë së ndërtimit.*
4. *Rekomandohet shpërndarje më e mirë e lëndëve në tipe veprimtarie*
5. *Rekomandohet rishikim i formatit të diplomës dhe procedurës së diplomimit*
6. *Një element që duhet përmirësuar lidhur me procesin e diplomimit është shpallja e fushave të temave të diplomave nga ana e departamentit dhe gjithashtu krijimi i kontrolleve të detyrueshme gjatë semestrit të katërt nga së paku 3 profesorë. Kjo do të ndihmojë shumë cilësinë e diplomave, mos përplasjen me tema të tjera dhe mendimi kritik nga më shumë se një profesor ndihmon në rritjen e cilësisë së temave.*
7. *Një element që rekomandohet të respektohet është sistemi i vlerësimit, sic është deklaruar në syllabus*

## 8. Mësimdhënia

Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion GVJ konstaton se: Universiteti EPOKA vepron mbi bazën e një game të plotë rregullash e procedurash të përcaktuara në rregulloren e studimeve dhe provimeve të programit të ciklit të dytë për Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile. Të



gjitha rregulloret janë të publikuara dhe i komunikohen gjithë stafit përmes formave zyrtare. Lloji i studimit të programit Master i Shkencave në Inxhinierinë e Ndërtimit është me kohë të plotë.

Programi zhvillohet në gjuhën angleze.

Programi përbëhet nga 13 lëndë, nga të cilat një Term Project, teza e masterit dhe 11 lëndë. Nga këto 11 lëndë 3 janë group study and research, special topic dhe individual study and research.

Organizimi i mësimdhënies përbën shtyllën kryesore të Institucionit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.

Instrumentet e mësimdhënies të cilat zbatohen në Universitetin EPOKA janë bashkëkohore duke numëruar pedagogët e moshës së re të cilët reflektojnë kreativitetin gjatë procesit të mësimdhënies, përvojë të madhe profesionale të stafit të pedagogëve të angazhuar si dhe grada shkencore të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në mësimdhënie.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies të cilat zbatohen janë të shumëllojta, duke nxitur studentin në pjesëmarrje direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies e vendosin pedagogun në rolin jo vetëm të lektorit por edhe të bashkëpunorit.

Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit është një nga elementët më të rëndësishëm që ky program studimi ka dhe një nga mjetet më të mira mësimdhënëse dhe mësimnxënëse. Duke qenë Master i Shkencave komponenti aplikativ është shumë i rëndësishëm dhe studentët e prekin më nga afër nëpërmjet këtij laboratorit. Rekomandohet që të shfrytëzohet më shumë nga programi master i shkencave.

Procesi i mësimdhënies përbëhet nga leksioni, projektet dhe detyrat e shtëpisë, praktikat, seminarët dhe laboratorët të parashikuara në programin e lëndës.

Vitit akademik fitohen 60 kredite ECTS. Diploma fitohet pas marrjes së paku 120 kredite (ECTS). Niveli i suksesit të studentit vlerësohet në bazë të provimeve në mes të semestrit; provimet finale, detyrat, prezantimet, projektet.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela 33)

Leksionet zhvillohen në ambientet e Fakultetit përmes projektorëve, tabelave, kompjuterëve. Seminarët dhe ushtrimet zhvillohen në klasë dhe jashtë saj me punë të pavarur të Studentëve. Laboratorët zhvillohen në grupe të vogla me studentë.

Vërehet që në tabelën 33 mungojnë orët e praktikës profesionale. Ky është një element që duhet rishikuar. Gjithashtu vërehen shumë pak orë në laborator dhe një diferencë shumë e madhe ndërmjet leksioneve dhe seminareve në nivel orësh. Gjithashtu detyrat kanë më shumë orë në auditor se sa seminarët. Ne rekomandojmë të rishpërndahen orët në auditor dhe gjithashtu duhen shtuar orët e praktikës profesionale dhe të laboratorëve.

Format e kontrollit të njohurive (Tabela 34)

Studenti i regjistruar në program është i detyruar të marrë pjesë në të paktën 60% të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore të kryera në auditor, lëndëve teorike, si dhe aktiviteteve mësimore dhe kërkimore të kryera në laboratorë dhe në praktikë. Studentët që kalojnë këtë kufi duhet ta përsërisin lëndën me të gjitha detyrimet përkatëse. Provimet zakonisht janë me shkrim. Pedagogu i lëndës mund të vendosë që gjithashtu të ketë një provim me gojë, një projekt ose detyrat e shtëpisë. Në këtë rast, vendimi duhet të njoftohet nga Koordinatori i Programit brenda dy javësh nga fillimi i semestrit. Provimet përgatiten dhe drejtohen / menaxhohen nga pedagogët përgjegjës për dhënie e atij kursi. Studenti mund të apelojë rezultatin e një



provimi brenda një jave nga data e publikimit të rezultateve, duke paraqitur një ankesë në Zyrën e Regjistrimit. Ankesa shqyrtohet paraprakisht nga profesori i lëndës në lidhje me ndonjë gabim në mbledhjen e pikëve. Dekanati merr vendim lidhur me ankesën për shkak të propozimit të Departamentit të lëndës. Vlerësimi sasior i detyrave të lëndëve të studentëve në Universitetin "EPOKA" kryhet me kredite sipas sistemeve amerikane dhe ECTS, të llogaritur sipas nenit 26 të kësaj rregullorjeje. Vlerësimi cilësor i detyrave të lëndëve të studentëve bëhet me nota alfabetike.

Procesi mësimdhënës është i përbërë nga leksione, projekte dhe detyra shtëpie, praktika, seminare dhe punë të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin e lëndës. Vërehet sasi shume e ulet e orëve në laborator, ky është një element që duhet përmirësuar.

Niveli i suksesit të studentit vlerësohen në bazë të provimeve në mes të semestrit, provimeve përfundimtare; detyrave, prezantimeve; projekteve. Por kjo është në varësi të lëndës.

Me propozim të drejtuesit të programit përkatës dhe me vendim të Komisionit Shkencor, studentit i jepet e drejta të futet në provim nëse ai/ajo nuk e ka ndjekur lëndën gjatë vitit për arsye bindëse dhe të dokumentuar, të cilat dorëzohen brenda tre ditësh. Bazuar kjo tek rregullorja e programit të studimit.

*Nuk vërehet aktivizim i studentëve në projekte shkencore apo aplikative të institucionit apo në bashkëpunim me të tjerë. Rekomandohet që duhet nxitur më shumë ndërveprimi i studentëve të programit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me tregun e punës jo vetëm në kuadër të praktikës profesionale por edhe më tej.*

## 9. Studentët

Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion GVJ konstaton se: Qasja e parë e një kandidati për të aplikuar për studime në Universitetin EPOKA është faja e internetit dhe forma e formularit e cila plotësohet nga kandidati me shënime personale biografike. Për të gjithë ata që duan të jenë pjesë e programeve Master që ofron universiteti, ndiqet një program këshillimor në mënyrë që aplikantët të jenë të mirëinformuar.

Pas marrjes së informatave të përgjithshme nga Zyra e Pranimeve, aplikantët shoqërohen për të marrë informacion më të detajuar nga pedagogët përkatës. Procedura për regjistrimin e studentëve, bazën e të dhënave / regjistrin e studentëve. Aplikimi kryhet pranë kësaj zyre, kjo e fundit e con në departament për shqyrtim dhe më pas është departamenti ai që vendos nëse kandidati do të pranohet apo jo.

Bazuar në Programin e Planifikimit të Karrierës për të diplomuarit, që tashmë është bërë traditë, Zyra e Pranimeve mirëpret çdo shkollë të mesme në mjediset e universitetit në bazë të një kalendari të hartuar nga kjo zyrë. Shtojca 11 Rregullorja Bazë, Shtojca 13 Rregullorja e Programit të Studimeve të Ciklit të Dytë.

Zyra për pranim është instanca e parë që një kandidat përballlet. Nëse ai pranohet duhet të plotësoj dosjen me dokumentacionin përkatës. Lista e dokumentacionit të regjistrimit e cila përmban: diplomë Universitare BsC, transkripti i notave Bsc, diploma e shkollës së mesme dhe rezultati i maturës, Vetëdeklaratë noteriale (mbi regjistrimin), CV-ja personale, Letër motivimi etj.. si dhe udhëzimet tjera për veprim të regjistrimit.

Pranohen të regjistrohen në programin e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", shtetas shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. Vërtetim nëpërmjet një dokumenti zyrtar për plotësimin e studimeve të ciklit të parë me diplomë Bachelor në Shqipëri ose jashtë vendit (ekuivalent me kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve);
2. Të plotësojnë kushtet e tjera të pranimit të përcaktuara në rregulloret e brendshme të Universitetit;
3. Pranojnë pagesën e një tarife fikse mujore ose vjetore.



Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të fakultetit për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Lejohet transferimi i studentëve në vitet e ndërmjetme nga universitete të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit, në Universitetin EPOKA dhe anasjelltas dhe në programet e studimeve universitare pas ekuivalencës së provimeve, sipas kurrikulave përkatëse. Transferimi midis programeve të ciklit të njëjtë lejohet.

Nga vizita në institucion dhe nga dokumentat e shqyrtuar rezulton si më poshtë:

Nga analiza e lëvishmërisë së studentëve, gjatë vizitës në institucion u pa që në vitin 2017-2018 është transferuar një student nga programi master profesional në programin Master i Shkencave. Për këtë student ju kërkua informacion sekretarisë dhe ky informacion na u dorëzua. Gjithashtu nga sekretaria na u vu në dispozicion një raport për numrin e studentëve. Në total që nga viti 2012 e në vazhdim:

- në profilin Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit ka patur 42 studentë të regjistruar;
- në profilin Menaxhim i Ndërtimeve ka patur 12 studentë të regjistruar. Në këtë profil ka patur vite që ska pasur studentë ose vetëm 1 student (2015-2016 - 1 student; 2016-2017, 2018-2019 - 0 studentë).

Dy profilet e tjera të studimit nuk kanë pasur asnjë student të regjistruar deri në vitin akademik 2017-2018, kjo për shkak të procedurave administrative për hapjen e këtyre programeve, por në vitin akademik 2018-2019 kemi:

- në profilin Inxhinieri e Resurseve Ujore ka 5 studentë të regjistruar. Ky është viti i parë që ky program është aktiv
- në profilin Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit ka 0 studentë të regjistruar për vitin akademik 2018-2019.

Duke qënë se profili Menaxhim i Ndërtimeve përgjithësisht ka pak studentë, kjo bën që në një pjesë të madhe të lëndëve ata të bashkohen me studentët e profilit "Inxhinieri e strukturave të ndërtimit". Kjo i humbet kuptimin profilizimit nëse të gjithë studentët kryejnë të njëjtat lëndë.

Gjatë vizitës së Institucionit GVJ ka verifikuar procesin administrimit të notave nga mësimdhënësit deri te administrata, procesi i parashtrimit të ankesës së studentit për provim dhe zgjidhja e sajë, regjistrat themeltar, regjistrat e notave, dosjet e studentëve, etj.

I gjithë procesi është transparent. Ai menaxhohet me system dixhital dhe që është një element shume pozitiv në mirë menaxhimin e të gjithë institucionit

Nga vizita në sekretari u pa rregjistrat e notave dhe u konstatua që studentët në pjesën më të madhe të kohës marrin të njëjtat lëndë megjithëse janë në profile të ndryshme. Gjithashtu u konstatua që nuk bëhet përditësimi i regjistrat të notave, megjithëse tanimë është detyrim ligjor; një studente e masterit shkencor nuk kishte sjellë akoma certifikatën e gjuhës së huaj Lidhur me këtë rekomandohet:

- të hartohet një procedurë për korrigjim gabimesh në regjistrin e notave (sic zbatohet në regjistrin themeltar).
- Rekomandohet vëmendje më e madhe në mbajtjen e dokumentacionit, në procesin e regjistrimit, transferimit të studentëve dhe dokumentimit të tij.

#### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Kanë të drejtën të aplikojnë për pranim në ciklin e dytë të studimeve:



- të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë në Republikën e Shqipërisë dhe përmbushin kriteret akademike të kriterëve të pranimit të Universitetit EPOKA.
- të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë jashtë Republikës së Shqipërisë dhe kanë të njëjtin nivel të ekuivalencës me ciklin e parë të studimeve të nxjerra nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve e Republikës së Shqipërisë, si dhe përmbushin standardet akademike të kriterëve të pranimit të Universiteti "EPOKA".
- të gjithë shtetasit e huaj, kuotat e të cilëve njoftohen çdo vit dhe se kanë përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë (ekuivalenca kërkohet për ciklin e parë të studimeve të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve e Republikës së Shqipërisë), si dhe përmbushin e standardeve akademike të kriterëve të pranimit të Universiteti "EPOKA"

#### Kriteret specifike për pranimin e studentëve

- Kërkohet që mesatarja e përgjithshme e notave të ciklit të parë të studimeve të jetë jo më pak se 7.5 nga 10.
- Kërkohet që aftësitë në gjuhën angleze të jenë të çertifikuara nëpërmjet një prej çertifikatave të njohjes së gjuhës angleze (përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve në nivelin B1 dhe më lart).

#### Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Institucioni ka rregulloren dhe një mori kërkesash lidhur me dokumentacionin dhe kushtet për regjistrim në këtë program studimi. Ky program studimi konsiderohet si vazhdim i studimeve të nivelit bachelor Inxhinieri Ndërtimi që institucioni e ofron. Ndërsa për pranim të studentëve të fushës së inxhinierisë të profileve tjera jashtë ndërtimit duhet të kalohen lëndët prerequisite, të cilat janë të caktuara me rregullore. Këto lëndë nuk futen në mesataren e studimeve.

Nga vizita në institucion, nga takimi me studentët u pa që të gjithë studentët punonin në profilin ku kishin studiuar.

Studentët u shprehën relativisht të kënaqur me përdorimin e laboratorit, asistencën e dhënë nga stafi i këtij laboratorit, etj. Biblioteka është një komponent shumë i rëndësishëm që i vjen në ndihmë studentit. Gjatë vizitës në IAL u konstatua që aty gjëndej një numër i madh titujsh në gjuhën angleze që ju shërbejnë mjaft studentëve për tu thelluar.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni i vënë në dispozicion ishte mëse i mjaftueshëm por nga GVJ u kërkua dokumentacion shtesë si model transferimi, numri i studentëve për profil. Këto dokumenta u vunë në dispozicion pas vizitës.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Shkencor" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Në këtë program studimi janë regjistruar studentë të cilët kanë plotësuar kriteret që përcakton legjislatura e vendit për studimet e nivelit Master i Shkencave si dhe rregullorja e studimit të Universitetit EPOKA. Të gjithë studentë që janë të pranuar në studime në këtë program zotërojnë diplomën Bachelor me 180
<b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të	



studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;

**Kriteri 3** Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;

**Kriteri 4** Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Shkencor" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;

**Kriteri 5** Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.

ECTS. Studentët e pranuar kanë plotësuar kriteret e përcaktuara nga rregullorja e programit dhe e Institucionit [citojmë]:

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për programin studimor të ciklit të dytë të gjithë shtetasit shqiptarë që mbajnë një diplomë Bachelor ose një diplomë ekuivalente në disiplina të përcaktuara nga institucionet përkatëse në Republikën e Shqipërisë dhe përmbushin standardet akademike të kriterëve të pranimit të Universitetit "EPOKA".

2. Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimeve të ciklit të dytë të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar ciklin e parë të studimit jashtë Republikës së Shqipërisë dhe kanë unifikimin (validimin) e programit të tyre studimor nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe përmbushin standardet akademike të kriterëve të pranimit të Universitetit "EPOKA".

3. Kanë të drejtë të aplikojnë në ciklin e dytë të studimeve, të gjithë studentët e huaj, të cilëve u aprovohen çdo vit kuotat, të cilët kanë përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë (nevojitet ekuivalentimi me ciklin e parë të studimeve të lëshuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë), si dhe përmbushin kriteret akademike të pranimit të Universitetit "EPOKA". Të gjithë studentët plotësojnë kriteret e pranimeve të vendosura nga ligji shqiptar dhe nga Rregullorja "EPOKA". Dosjet e paraqitura nga studentët janë të disponueshme në Zyrën e Pranimit.

Kriteret e pranimit për programin e studimit të ciklit të dytë në Universitetin "EPOKA" janë:

1. Nxënësi duhet të ketë një minimum GPA prej 2.5 nga 4.00 për studentët që kanë përfunduar programet e studimeve Bachelor në Universitetin "EPOKA" ose 7 nga 10.00 ose GPA ekuivalente për studentët që kanë përfunduar programet e studimeve Bachelor në Institucionet e tjera të Arsimit të Lartë (IAL);

Për studentët e pranuar në studime ishte kusht që përpara regjistrimit në këtë program duhet të dëshmojnë certifikatën e testit të gjuhës Angleze sipas udhëzimit të përcaktuar nga Institucionet e MASR-it. *Rekomandohet vëmendje më e madhe, në procesin e regjistrimit, dokumentimit të tij.*

Çdo vit Departamenti miraton kuotat e pranimit për vitin e ardhshëm akademik. Institucioni dëshmon se teston vlerësimin herë pas here të politikave të pranimit të studentëve në programe studimi si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin eventual të kriterëve të pranimit.

**Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.**

**Kriteri 1** Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe

Të gjitha informacionet lidhur me studentët, sukseset e tyre, punësimet e tyre në përfundim të programeve të studimeve institucioni i ka publike dhe disa prej tyre në faqen e internetit. Përveç kësaj studentëve ju jepen edhe broshura e cila përmban shumë përshkrime lidhur me student dhe studimet. Studentëve u



<p>vlefshërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>jepet informacion rreth mundësive për punësim pas diplomimit në përfundimin e këtij programi studimor. Forumet e hapura me ekspertë nga fusha dhe kompani të ndryshme organizohen shpesh, panairët e karrierës organizohen çdo vit në mjediset e EPOKA për të ndihmuar dhe orientuar studentët mbi mundësitë e punësimit që mund të kenë.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion dhe takimet me studentë, ata ishin shumë të vetëdijshëm për rëndësinë e programit të studimit, rëndësinë e akreditimit të këtij programi si një mjet për ta bërë licencën e tyre sa më të vlefshme. Ndërkohë, për studentët e regjistruar organizohen takime ku shpjegohen procesi i akreditimit të institucionit dhe programeve përkatëse.</p> <p>Në Universitetin EPOKA funksionon Zyra e Pranimit dhe zyra e Planifikimit të karrierës / Alumni e ngritur në Universitet e cila i ndihmon studentët me shërbime, këshilla lidhur me karrierën. Kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit pas diplomimit, për organizime të ndryshme lidhur me punësimin, etj. Zyrës në fjalë ju propozua që përveç pyetjeve standarde pas përfundimit të programit, të ketë pyetje edhe lidhur me vlefshërinë e dijeve të marra, lëndë specifike të cilat i kanë shërbyer më së shumti ose lëndë të cilat nuk i kanë përdorur asnjëherë në punën e tyre. Këto pyetje do të ndihmonin akoma më shumë në përmirësimin e programit të studimit</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Universiteti “EPOKA” ka statistika vjetore mbi numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që janë përfunduar.</p> <p>Sekretaria së bashku me sekretarinë e Departamentit ka statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi studimor, si dhe pezullimet e ndaluara ose ndërprerja e studimit ose dështimi për të përfunduar me sukses vitin akademik.</p> <p>Sekretaria (zyra e regjistrimeve) dhe sekretaria e departamentit kanë të dhëna mbi ecurinë akademike të studentëve nga pranimi në diplomim.</p> <p>Ata ndjekin hap pas hapi gjatë gjithë procesit të mësimdhënies dhe kanë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të dhënat përkatëse për ecurinë akademike të studentëve nga pranimi në diplomim, duke përfshirë vlerësimin dhe notat në provime, pjesëmarrjen në lëndë, kërkesat e ndryshme të studentëve, sanksionet disiplinore, etj. Gjatë vizitës në IAL u verifikuan të gjitha dokumentacionet e mësipërme. Nga vizita në sekretari u pa që nuk bëhet përditësimi i regjistrimit të notave, megjithëse tanimë është detyrim ligjor. Lidhur me këtë fakt rekomandohet të hartohet një procedurë për korrigjim gabimesh në regjistrin e notave dhe rekomandohet një vëmendje më e madhe lidhur me procesin e transferimit dhe dokumentimit të tij.</p>



**Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

**Kriteri 1** Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

**Kriteri 2** Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

Universiteti "EPOKA" ka një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve studimore të ciklit të dytë ose programeve të ciklit të integruar dhe punësimit të tyre. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Ish-studentët mban bazën e të dhënave të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve studimore të ciklit të dytë ose programeve të studimeve të ciklit të integruar si dhe vendit të tyre të punës. Universiteti "EPOKA" ka një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e tyre në cikle të tjera studimi. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Ish-studentët mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e tyre në cikle të tjera studimi.

**Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.**

**Kriteri 1** Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

**Kriteri 2** Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

**Kriteri 3** Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Të gjitha informacionet lidhur me studentët, programin e studimit, afatin e provimeve, afatin e përfundimit Institucioni i ka publike dhe disa prej tyre në faqen e internetit. Gjatë javës së orientimit, studentët informohen në detaje mbi programet e studimit, organizimin e tyre, afatin e përfundimit dhe statusin e akreditimit të programit. Përveç kësaj studentëve ju jepen edhe broshura e cila përmban shumë përshkrime lidhur me student dhe studime. Të gjithë studentët ishin të informuar lidhur me procesin e akreditimit.

Rezultati i provimeve të mbajtura ju publikohet studentëve përmes platformës elektronike ICTCO e cila është platformë e ngritur nga vetë institucioni dhe bën lidhjen në kohë reale të pedagogut me studentin, jep informacion mbi vlerësimin, mbi bibliotekën, etj. Kjo platformë lidh të gjitha hallkat e institucionit qoftë ato administrative qoftë ato akademike

Përgjegjësi i lëndës/modulit jep vlerësimin sipas kritereve të dhëna edhe në syllabus. Kreu i modulit diskuton haptazi me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

**Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.**

**Kriteri 1** Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

**Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Institucioni ka hierarki të organizimit të njëjësive akademike dhe udhëheqje të programeve të studimeve. Përmes personave përgjegjës të programeve, studentëve ju jepet ndihmë në zgjidhje të çështjeve problematike lidhur me procesin mësimor, sikur mund të jenë literatura e jashtme, lidhja me biznesin, praktika mësimore, pakënaqësi lidhur me një lëndë etj.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Konstatimi i GVJ lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me studentët, në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile, ofruar nga Universiteti EPOKA, është se standardet e kërkuara plotësohen duke u mbështetur në faktet e gjetura gjatë vizitës në IAL, takimet me studentët si dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm. Cilësia e ofertës akademike, ambientet të cilat ofrojnë komoditet, raportet Profesor/Studentë janë të niveleve shumë të



kënaqshme.

2. Ekzistenca e disa zyrave në mbështetje të studentëve, i bën ata të mirë informuar dhe ju jep siguri në zgjedhjet që bëjnë. Këto zyra gjithashtu disponojnë statistika mjaftë të rëndësishme lidhur me punësimin, internship-et dhe aktivizimin e studentëve. Zyra për këshillim karriere dhe Alumni organizon edhe panairin e karrierës për tju ardhur në ndihmë studentëve
3. Sistemi i vlerësimit dhe marrja në konsiderate e ankesave është një tjetër element që i bën studentët të lumtur
4. Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit është një nga elementët më të rëndësishëm që ky program studimi ka. Duke qenë Master i Shkencave komponenti aplikativ është shumë i rëndësishëm dhe studentët e prekin më nga afër nëpërmjet këtij laboratorit. Rekomandohet përdorim më i shpeshtë i laboratorit
5. Biblioteka është një komponent shumë i rëndësishëm që i vjen në ndihmë studentit. Gjatë vizitës në IAL u konstatua që aty gjënde një numër i madh titujsh në gjuhën angleze që ju shërbejnë mjaft studentëve për tu thelluar.

Elementë që duhen përmirësuar:

1. U konstatua që studentët e masterit profesional dhe atij shkencor, gjatë vitit të parë kryejnë të njëjtat lëndë me të njëjtin syllabus dhe detyra
2. Dokumentacioni në disa raste ishte i paplotë dhe i pasaktë. Mungonte përditësimi i regjistrimit të notave

Rekomandime:

1. Rekomandohet të rishikohet procesi i transferimit nga master profesional në master shkencor pasi masteri profesional mund të përdoret si tampolinë në programin Master i Shkencave duke shmangur kriterin e mesatares.
2. Rekomandohet të hartohet një procedurë për korrigjim gabimesh në regjistrin e notave (sic zbatohet në regjistrin themeltar).
3. Rekomandohet vëmendje më e madhe, në procesin e regjistrimit, transferimit dhe dokumentimit të tij.

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### **10. Kërkimi shkencor**

Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion GVJ konstaton se: Lidhur me kërkimet shkencore, projektet kombëtare dhe ndërkombëtare institucioni ka një background të pasur të tyre. Gjithashtu dhe personeli akademik është kreativ dhe gjithmonë përditësohen, ndjekin dhe zbatojnë projekte të cilat lidhen me fushat e studimeve dhe mësimëve. Gjatë vizitës GVJ pati qasje te materialet e shumta të institucionit dhe u konstatua me kënaqësi që kërkimi shkencor jo vetëm zhvillohet në institucon por edhe stimulohet për tu cuar më tej.

Universiteti "Epoka" është një institucion i arsimit të lartë, i orientuar drejt kërkimit shkencor. Kërkimi shkencor përfaqëson një nga aspektet kryesore të tij. Universiteti EPOKA është i përkushtuar në krijimin e kushteve të favorshme për aktivitetet shkencore dhe kërkimore dhe të ndihmojë stafin akademik në arritjen e rezultateve konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar brenda mundësive të burimeve dhe instrumenteve që institucioni ju ka vënë në dispozicion. Universiteti inkurajon duke mbështetur financiarisht të gjithë pjesëtarët e stafit akademik që të jenë aktivë në fushën e kërkimit shkencor. Në fund



të çdo viti akademik, të gjitha botimet shkencore të publikuara nga stafi akademik vlerësohen nga një juri e veçantë në bazë të kriterëve të përcaktuara në "Rregulloren për Nxitjen e Botimeve Shkencore" të Universitetit, duke u mbështetur në këto kriteret përkatëse. Çdo fund viti, Këshilli Administrativ i Universitetit përcakton masën e shpërblimit për çdo pikë të fituar dhe në bazë të pikëve të grumbulluara secili anëtar i stafit akademik përfiton shpërblimin përkatës. Universiteti "Epoka" jep gjithashtu, mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si rregull, secili anëtar i stafit akademik ka të drejtë të marrë ndihmë financiare një herë në vit për pjesëmarrje në këto aktivitete. Njëherësh, organizimi ose bashkë-organizimi i konferencave dhe veprimtarive shkencore në nivel ndërkombëtar është një tjetër dimension i rëndësishëm i politikës së kërkimit shkencor të Universitetit "Epoka". Aktivitetet e kërkimit shkencor bashkërendohen nga Zyra e Kërkimit dhe Projekteve në bashkëpunim të ngushtë me Rektoren, Qendrat Kërkimore dhe Fakultetet.

#### Objektivat strategjike shkencore:

##### 1. Zhvillimi i veprimtarive kërkimore

Qëllimi 1: Integrimi në kriterin e projekteve kërkimore të BE-së

Qëllimi 2: Rritja e numrit të projekteve kërkimore ndërkombëtare

Qëllimi 3: Rritja me 25 % e numrit të projekteve kërkimore kombëtare për të cilat është bërë një aplikim.

##### 2. Rritja e numrit të botimeve dhe cilësisë së tyre

Qëllimi 1: Rritja e numrit të projekteve që mbështeten nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ndarja e rezultateve shkencore me publikun vendas dhe të huaj.

Qëllimi 2: Rritja me 25% në vitin 2018 e numrit të botimeve shkencore të njohura në rrafsh ndërkombëtar.

##### 3. Organizimi i aktiviteteve shkencore dhe nxitja e pjesëmarrjes

Qëllimi 1: Rritja me 25% në vitin 2017 të pjesëmarrjes së stafit tonë akademik dhe ndihmës studiuesve në aktivitete shkencore.

Qëllimi 2: Rritja me 25% në vitin 2017 e numrit të aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

##### 4. Rritja e numrit të projekteve ndërdisiplinore

Qëllimi 1. Brenda vitit 2017, duke u mbështetur në zhvillime teknologjike dhe shkencore, të nxitet kërkimi shkencor në dy lëndë apo fusha të reja në vit.

Qëllimi 2. Në fund të vitit 2017, të arrihet një marrëveshje bashkëpunimi me Universitete dhe institucione të tjera në fushën e Kërkimit dhe Zhvillimit.

Implementimi i njohurive të marra në projekte konkrete nga kërkimi i vazhdueshëm shkencor dhe puna akademike e Institucionit tregon rezultatet e arritura duke prezantuar disa nga projektet e mëposhtme.

Projekte Ndërkombëtare të kërkimit shkencor në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, përkatesisht në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit janë të shumtë dhe tregojnë një dëshirë të institucionit për të bashkëpunuar dhe për të rritur kapacitetet njerëzore dhe fizike.

Numri i lartë i projekteve dhe partneritetet ndërkombëtare tregojnë një fokus të veçantë që institucioni tregon lidhur me kërkimin shkencor. Sistemi i pikësimit të stafit lidhur me aktivitetin kërkimor është një vlerë e shtuar e cila rit më tej kontributin që universiteti duhet të jap dhe jep në këtë drejtim.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 40)

Vërehet një numër shumë i lartë botimesh nga personeli akademik i Unviersitetit EPOKA. Kjo ndihmon dimensionin kërkimor të institucionit. Vërehet gjithashtu që kërkimi shkencor bërnda procesit mësimor mungon totalisht. Ky element mund të rritet ndjeshëm nëse vihet në përdorim të plotë laboratorit i inxhnierisë së ndërtimit nga studentët e masterit shkencor.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni i vënë në dispozicion ishte i mjaftueshëm dhe nga GVJ nuk u kërkua dokumentacion shtesë

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik i angazhuar në Institutin ka angazhime permanente edhe për kërkime shkencore të përcjellura me punime shkencore nëpër konferenca dhe revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari dhe organizimin e një sërë konferencash shkencore jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit. Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e dorëzuar vërehet një numër i lartë publikimesh nga ana e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit MSc në Inxhnieri Ndërtimi.
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj. <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Tek të gjitha lëndët e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhnieri Ndërtimit, me profile mësimi zhvillohet në gjuhë Angleze. Pedagogët falë formimit të tyre brënda dhe jashtë vëndit zotërojnë gjuhën angleze.  Certifikata e gjuhës angleze nuk ishte pjesë e dosjes së personelit akademik por kjo nuk ishte e nevojshme duke parë përvojat dhe publikimet në gjuhë të huaj që stafi i angazhuar në programin e studimit ka. Shumë nga stafi ose janë të huaj, ose kanë studiuar jashtë vëndit ose kanë studiuar pranë Universitetit EPOKA ku gjuha bazë është gjuha angleze. Për studentët ky fakt nuk përbën një problem pasi ata i nënshtrohen një testi anglshiteje në hyrje ose vijën nga sisteme arsimore para universitare ku poashtu gjuha bazë është gjuha angleze.
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; <b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë	Janë identifikuar dhe zhvilluar një sërë trajnimesh "in house", pra brenda institucionit me partnerë të ndryshëm ndërkombëtare dhe kombëtarë për fusha të ndryshme.  IAL inkurajuar personelin akademik për të filluar ciklin e tretë të studimeve; kështu brënda universitetit ofrohet cikli i tretë i



vendit.	studimit PhD në Inxhnieri Ndërtimi, ku stafi akademik ka kryer studimet, gjithashtu nga vizita në IAL na u tha që një staf aktualisht ndodhet në Portugali për shkak të studimeve të doktoraturës. Kjo do të thotë që institucioni i nxit dhe i stimulon stafin akademik të thellohet më tej në ciklin e tretë të studimeve si brenda dhe jashtë vëndit. Universiteti i mbështet jo vetëm moralisht por edhe financiarisht kërkuesit e rinj shkencor. Zyra e Projekteve dhe Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare ndihmojnë stafin gjatë procedurave. Shumë nga trajnimet jashtë vëndit financohen nga projektet europiane si: K-Force, QAINAL, Erasmus+. Projekte që ofrojnë mundësi trajnimi për stafin dhe studentët
---------	--

**Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vëndit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni harton raportin vjetor të aktiviteteve të hartuara në fillim të vitit dhe cilëson realizueshmërinë e tyre. Universiteti ka një shërbim dixhital që mbledh, ruan dhe shpërndan materiale dixhitale e njohur si “DSpace”. Fakultetet e përditësojnë listën e botimeve dhe veprimtaritë shkencore të stafit akademik.</p> <p>Institucioni ka bankën e shënimeve për botimet si dhe vet botimet të qasshme në bibliotekën e sajë. Universiteti “Epoka” mbështet kërkimin shkencor edhe përmes Zyrës së Kërkimeve dhe Projekteve. Ai ka një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda dhe jashtë vëndit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Projektet në të cilat merr pjesë Institucioni janë publike në faqen e internetit të Universitetit. Zyra e Kërkimit dhe Projekteve bashkë me Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare mirëmbajnë bazën e të dhënave të projekteve ku merr pjesë stafi.</p>
---	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. GVJ gjatë vizitës në institucion, takimeve me personelin akademik, administratën, studentët, stafin menaxherial të institucionit ka identifikuar punët kërkimore të të gjithë stafit akademik dhe se objektivat dhe misioni i Universitetit EPOKA përkon me kërkimin shkencor. Institucioni së bashku me personelin dhe studentët realizojnë punë kreative në fushat përkatëse. Kreativiteti i referohet përveç mësimdhënies edhe pjesës tjetër të punës dhe veçanërisht kërkimeve shkencore dhe atyre aplikative që realizohen edhe falë laboratorit të Inxhinierisë së ndërtimit.
2. Personeli Akademik është i përkushtuar të përditësohet me metodat e avancuara të mësim dhënies dhe publikimeve shkencore.
3. Mundësia e publikimeve dhe mbështetja financiare është një shans i mirë për stafin akademik që të publikojnë punimet e tyre.
4. Pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare është një mundësi e shkëlqyer për stafin akademik dhe administrativ. Stafi akademik i angazhuar në këto projekte ka mundësinë të përballlet me realitete të reja dhe të mësojë nga këto përvoja.
5. Prania e stafit të huaj diversifikon metodat e mesim dhënies dhe sjell një frymë ndryshe brenda auditoreve.



6. Projekte Ndërkombëtare të kërkimit shkencor në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, përkatesisht në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit janë të shumtë dhe tregojnë një dëshirë të institucionit për të bashkëpunuar dhe për të rritur kapacitetet njerëzore dhe fizike

Krahasimi i Raportit të Brendshëm me gjetjet në vend janë jashtëzakonisht të vogla dhe kjo tregon se puna institucionale është cilësore.

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion, rezultoi se Universiteti EPOKA, ka vendosur marrëdhënie me shumë institucion të arsimit të lartë (vendase dhe të huaja), shoqëri tregëtare private, institucione shtetërore si dhe i kushton vëmendje lidhjes së teorisë me praktikën, prioritet i shprehur në mision e institucionit dhe realizimin e tij me nënshkrimin e marrëveshjeve të ndryshme me institucionet e llojit të lartpërmendur.

Konstatuam se Universiteti EPOKA është një institucion i karakterizuar nga një dimension i spikatur ndërkombëtar, gjë që reflektohet në mënyrën e organizimit të aktiviteteve akademike, në shkëmbimin e studentëve dhe stafit me shumë institucione të tjera të huaja kryesisht me vende të BE.

Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile ofron dy vite studimi të avancuar për studentët e diplomuar.

Studentët e Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit duhet të kryejnë një praktikë verore gjatë periudhës së studimeve, një në kantier ndërtimi dhe një tjetër në studio profesionale. Studentët kanë kryer praktika verore përveç se në Shqipëri dhe në Gjermani, Itali, Turqi, Kosovë dhe Greqi.

Fakulteti I Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Departamenti I Inxhinierisë së Ndërtimit kanë kontakte të vazhdueshme me kompanitë që operojnë në Treg. Departamenti I IN ka nënshkruar marrëveshje me disa nga këto kompani. Pikat kryesore të këtyre marrëveshjeve janë praktika pune të studentëve, leksione të hapura, rastet studimore të tezës së studentit, aktivitete të kërkimit shkencor, etj.

Institucioni ka një zyrë të dedikuar marrëdhënieve ndërkombëtare.

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (ZMN) është në varësi të Zyrës së Rektorit në Universitetin "Epoka". Detyra kryesore e kësaj zyre është zhvillimi dhe zbatimi i politikave ndërkombëtare dhe nxitja e procesit të ndërkombëtarizimit të universitetit.

ZMN mbështet dhe garanton materializimin e politikave ndërkombëtare të universitetit në përputhje me objektivat strategjike dhe udhëzimet e përcaktuara nga Zyra e Rektorit dhe në konsultim me partnerët e fakultetit.

Për të arritur qëllimet e lartpërmendura në kuadrin e ndërkombëtarizimit, ZMN mbështet koordinimin ndërkombëtar me institucionet e tjera dhe herë pas here e përfaqëson universitetin jashtë vendi dhe promovon imazhin ndërkombëtar të universitetit si një qendër globale e ekselencës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Misioni i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare (ZMN) është që të krijojë kushtet e nevojshme për të promovuar dhe intensifikuar ndërkombëtarizimin e Universitetit "Epoka".

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela 41)

Vërhet që instiucioni ka një numër të madh bashkëpunimesh. Më konkretisht:

- 55 insitucione shtetërore
- 8 organizata profesionale



- 27 bashkëpunime me Komunitetin e biznesit, Tregu i Punës
- 9 antarësime në organizata ndërkombëtare
- 6 marrëveshje bashkëpunime me universitetete europiane
- 10 pedagog të ftuar të huaj
- 11 pedagog që dërgohen jashtë
- Dhe një numër të madh studentësh që janë pjesë e mobiliteteve

Të gjitha këto rrisin dimensionin ndërkombëtar të Unviersitetit EPOKA

Lidhur me mobilitetin e studentëve janë 8 student të dërguar nga dega e inxhnierisë së ndërtimit por nuk specifikohet në tabelë nëse janë master apo bachelor. Nga vizita në instucion dhe nga takimi që patëm më përgjegjësen e zyrës nga u tha që nga programi Master i Shkencave është dërguar vetëm një studente për program shkëmbimi.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion: Dokumentacioni i vënë në dispozicion ishte mëse i mjaftueshëm dhe nga GVJ nuk u kërkua dokumentacion shtesë

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Per kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Shkencor", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion e vënë në dispozicion konkludojmë se Universiteti EPOKA, është shumë i angazhuar në integrimin e aspekteve të formimit teorik, me atë kërkimor dhe praktik.</p> <p>Për këtë arsye janë ndërtuar marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me organizma të ndryshëm publik dhe privatë.</p> <p>Sikurse është përmendur edhe më lart kurrikula e programit është konceptuar duke u bazuar në informacionin e grumbulluar nga tregu i punës, kompanitë e ndryshme si dhe studimet e tjera çka është menduar për një program me fokus konkret, integrim në tregun e punës.</p> <p>Universiteti "Epoka" ndjek një politikë të favorshme për lëvizjen e studentëve në institucione arsimore të huaja me të cilat ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve organizohen konferenca të përbashkëta ndërkombëtare, projekte kërkimore, trajnime profesionale dhe praktika mësimore të studentëve.</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Gjatë vizitës u vu re se kishte një frymë shumë të mirë bashkëpunimi midis anëtareve të stafit në nivel departamenti ashtu dhe institucional. Kjo inkurajon dhe ka nxitur nisma për projekte të përbashkëta midis stafit, publikimeve të ndryshme si dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore por dhe duke u kujdesur për një jete të pasur sociale që kuron marrëdhënie të mira personelit midis tyre.</p> <p>Institucioni nxit bashkëpunimin me anë të shkëmbimit të informacionit mes stafit, kryesisht me email. Gjithashtu, informacioni ndahet dhe shkëmbehet në seminare që organizohen rregullisht "Kërkimi Shkencor dhe Mësimdhënia: të mësosh nga njëri-tjetri". Institucioni publikon dhe përditëson Udhëzuesin e Stafit, organizon takime orientimi me stafin e ri</p>



	që punon me kohë të plotë dhe ata me kohë të pjesshme etj.
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti disponon një numër të madhë marrëveshjesh me universitete të rajonit por dhe më gjerë.</p> <p>Universiteti EPOKA, ka një rrjet të zgjeruar të partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë të përzgjedhur në përputhje me strategjinë e institucionit. Ky rrjet pasurohet vazhdimisht në mënyrë që institucionet dhe llojet e partneritetit të ndihmojnë në arritjen e objektivave të institucionit.</p> <p>Universiteti EPOKA ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës në varësi të programit të studimit.</p> <p>IAL bashkëpunon me komunitetin e biznesit dhe institucionet publike për organizimin e seancave dëgjimore, konferencave apo trajnimeve të përbashkëta.</p> <p>Universiteti realizon një raport analitik për të parë dhe kuptuar përfitimin e marrëveshjeve kontraktuale në funksion të realizimit të programeve.</p> <p>Institucioni organizon trajnime profesionale të përvitshme duke ftuar ekspertë të huaj për kërkimin shkencor dhe zhvillimin.</p> <p>Duke u mbështetur në kalendarin vjetor të aktiviteteve, Departamenti mbështet trajnimet profesionale me anë të leksioneve të hapura dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve të huaj dhe vendas. Në fund të çdo viti akademik, secila njësi harton një raport vjetor që i dorëzohet zyrës së sigurimit të cilësisë. Institucioni bën një sintezë dhe mes të tjerave edhe analizon përfitimet e marra nga programi i studimit në kuadër të kësaj marrëveshjeje.</p>
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<b>Nga vizita në Institucion dhe nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstato:</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas dhe të huaj, për kryerjen e praktikave të studentëve të tij. Universiteti EPOKA ka shfrytëzuar më së miri bashkëpunimet me aktorë të biznesit si për marrje përvoja, këmbim stafi, shkëmbim eksperiencash, punësim studentësh, njohja e funksionimit të kantierit, laboratorë specifike etj.</li> <li>2. Institucioni ka arritur të anëtarësohet në disa nga organizatat më të rëndësishme të Inxhinierisë së Ndërtimit. Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ndërmjet personelit të tij. Në filozofinë e institucionit standardi për bashkëpunimin me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj është shprehur shumë qartë në Strategjinë e Zhvillimit. Jo vetëm përfshirja por dhe pjesëmarrja e stafit në shumë evente kombëtare dhe ndërkombëtare sikurse janë, konferencat, simpoziumet, workshop-et bëjnë të mundur rritjen e dimensionit ndërkombëtar të institucioni dhe rrjedhimisht të programit në fjalë.</li> </ol>	



## I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### A) Rekomandimet e mëparshme

- Përmirësimi i mëtejshëm i kërkimit shkencor dhe zgjerimin e burimeve për materialet kërkimore
- Përmirësimi i procesit të përzgjedhjes së studentëve që njohin gjuhën angleze në nivele të kënaqshme
- Të sigurohet që studentët dorëzojnë në fund të programit një certifikatë për njohuritë në gjuhën angleze e cila njihet në nivel ndërkombëtar.

### B) Analiza përmbledhëse për plotësimin e rekomandimeve nga akreditimi i parë

GVJ duke u bazuar në RVB, Dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën pranë Universitetit EPOKA, konstaton se rekomandimet e mëparshme janë plotësuar

## II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT)

### a. **Pika të forta:**

- 1) Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit", përputhet me misionin dhe objektivat e Institucionit.
- 2) Përkushtimi maksimal i stafit Akademik për përmbushjen e misionit dhe objektivave për këtë program studimi Msc në "Inxhinieri Ndërtimi". Metodatat e zbatuara në mësimdhënie nga stafi akademik, i cili është gjithmonë në kërkim të përmirësimit të vetëvetes.
- 3) Staf lokal dhe ndërkombëtar të kualifikuar dhe me eksperiencë praktike profesionale, i cili transmeton dijet në mënyrën më të mirë dhe më të kuptueshme për studentët;
- 4) Mësimdhënia në gjuhën angleze, që përfshin përzgjedhjen e stafit mësimdhënës me kritere të njohjes së kësaj gjuhe, por edhe të studentëve
- 5) Administrata e institucionit është profesionale, garanton shërbime të shpejta, cilësore, efikase dhe të sigurta. Vërehen cilësi në shërbime, siguri të informacionit, pacënueshmëri të të dhënave personale të individëve dhe një hierarki të urdhrave dhe funksioneve respektuese.
- 6) Menaxhimi i mirë i procesit të mësimdhënës dhe mësimnxënës. Një ndihmë për këtë është sistemi i menaxhimit dixhital që nga regjistrimi dhe deri në diplomim të studentëve;
- 7) Infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin e Programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile, është në përputhje me standardet e vendit dhe të BE-së. Zhvillimi i procesit akademik dhe kërkimor në mjedise shumë miqësore dhe stimuluese si për studentet ashtu edhe për personelin akademik. Ekzistenca e laboratoreve të pajisura mirë dhe që mbështesin procesin mësimor. Biblioteka është një komponent shumë i rëndësishëm që i vjen në ndihmë studentit. Gjatë vizitës në IAL u konstatua që aty gjëndeja një numër i madh titujsh në gjuhën angleze që ju shërbejnë mjaft studentëve për tu thelluar



- 8) Menaxhimi i të ardhurave financiare, rritja e zërave buxhetorë si fondet për pagat e stafit në rritje, për kërkimin shkencor në kuptimin e gjerë, përfshirë këtu edhe aktivitetet, botimet, anëtarësimet në rrjete ndërkombëtare apo investime. Mbështetja që institucioni i jep personelit akademik për të zhvilluar kërkim shkencor.
- 9) GVJ vlerëson se Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile është përmbajtësor, i studiuar dhe i projektuar në mënyrë që të sigurojë një student/profesionist të përgatitur në aspektin teorik dhe cilësi profesionale për tregun e punës në vend dhe Europë. Struktura, përmbajtja e kurrikulës dhe programet janë në përputhje me kriteret e përgjithshme shtetërore për këto programe, me modele analoge të vendeve Europiane e atyre Anglosaksone dhe të kontekstualizuara në mjedisin dhe kërkesat globale e lokale të tregut të punës;
- 10) Bashkëpunimet e shumta që Universiteti Epoka ka me tregun e punës dhe me partnerë ndërkombëtarë, i japin mundësi stafit dhe studentëve të zhvillohen më tej dhe të mësojnë nga këto eksperiencat. Pjesëmarrja e stafit në shumë evente kombëtare dhe ndërkombëtare sikurse janë, konferencat, simpoziumet, workshop-et bëjnë të mundur rritjen e dimensionit ndërkombëtar të institucionit dhe rrjedhimisht të programit në fjalë;
- 11) Projekte Ndërkombëtare të kërkimit shkencor në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, përkatesisht në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit janë të shumta dhe tregojnë një dëshirë të institucionit për të bashkëpunuar dhe për të rritur kapacitetet njerëzore dhe fizike
- 12) Eksperiencat aplikative që studentët e Universitetit EPOKA marrin në mënyrë të vazhdueshme falë edhe rrjetit të gjerë të partnerëve dhe projekteve konkrete, i përgatit ata për tregun lokal dhe global të punës;

**b. Pika të dobëta:**

- 1) Programi i studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile nuk ka të parashikuar praktikë profesionale
- 2) Programi i studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi, me profile vërehet se ka një shpërndarje jo shumë korrekte të lëndëve në tipe veprimtarie (A-F). Rezultati se ka mbi 50% të lëndëve me zgjedhje, përfshirë këtu edhe lëndët karakterizuese;
- 3) Programi i studimit MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile gjatë vitit të parë kryen 7 (shtatë) lëndë të njëjtat me programin e studimit Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi. Gjatë procesit të transferimit këto lëndë njihen pothuajse 100% në numër kreditesh.
- 4) Vërehet që realizohen shumë pak orë në auditor, krahasuar me orët e planifikuara në planin mësimor
- 5) Formati i diplomës së programit të studimit nuk ishte konform rregullave dhe standardeve;

**c. Mundësitë:**

- 1) Pas mbarimit të këtij programi studimi, studentët mund të punësohen si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik
- 2) Mundësi shkëmbimi pranë institucioneve partnere qoftë për studentët qoftë për stafin. Kjo mundësi vjen falë ritjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni ka firmosur me partnerë lokal dhe ndërkombëtar.
- 3) Mundësi reale punësimi pranë një prej kompanive me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi dhe të cilat operojnë në këtë fushë



- 4) Cilësia në rritje dhe ndërgjegjësimi për të është një mundësi që institucioni e siguron për studentët dhe stafin
- 5) Kurrikula e programit të studimit, duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës, u ofron mundësi reale studentëve për të qënë të gatshëm për tregun e punës
- 6) Mundësi të vazhdimit të studimeve të mëtejshme në doktoratë, pranë universitetit EPOKA ose pranë një prej universiteteve partnere në këtë fushë;

**d. Pengesat:**

- 1) Imazhi që Universitetet private kanë në tregun arsimor shqiptar i bën ato pak konkurrese në treg.
- 2) Mungesa e fondeve të BE për arsimin e lartë në shqipëri për shkak të mos qënies së vendit antar të BE.
- 3) Një industri e pazhvilluar kombëtare bën që mos të kenë fokus kërkimin shkencor në Universitete e për rrjedhojë mos ta mbështesin atë.
- 4) Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor e kanë penalizuar programin e studimit
- 5) Kriza financiare ka ndikuar në uljen e burimeve financiare në shoqërinë Shqiptare e për rrjedhojë ndihet një ulje e numrit të studentëve në arsimin universitar privat. Kriza në të cilën prej shumë vitesh ka kapur fushën e ndërtimit dhe të projektimit, shpesh herë i bën studentët të stepen përpara zgjedhjes së këtij profesioni si profesioni i tyre i ardhshëm. Kjo e pengon universitetin të rritet në nivel sasior studentësh; Gjithashtu rritja e konkurrencës globale, rajonale e lokale në fushën e arsimit të lartë shpesh herë kthehet në pengesë. Kjo konkurrencë jo gjithmonë është e ndershme dhe shpesh herë i vë institucionet serioze përballë kushteve jo të favorshme;
- 6) Tregu informal në fushën e ndërtimit penalizon inxhinierët e rinj dhe të arsimuar
- 7) Fakti që të gjitha lëndët zhvillohen në gjuhën angleze i bën studentët shqiptarë të përballen me një terminologji disa herë të panjohur kur dalin në punë në Shqipëri;

**REKOMANDIME:**

- 1) *Rekomandohet shpërndarje më e mirë e lëndëve dhe krediteve në tipe veprimtarie, ulja e përqindjes së lëndëve më zgjedhje dhe rritja e përqindjes së lëndëve të detyrueshme*
- 2) *Rekomandohet zbatimi i orëve në auditor të planifikuara në planin mësimor. Shtimi i orëve në auditor do t'i bëjë studentët të përthithin më mirë informacionin e dhënë dhe do të kenë mundësi të shfrytëzojnë asetet e shkollës si biblioteka dhe laborator pas ky laborator është një vlerë e shtuar për Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë por mbi të gjitha për departamentin e Inxhinierisë së ndërtimit.*
- 3) *Rekomandohet futja e një lënde aplikative "Praktikë profesionale"*
- 4) *Rekomandohet që sasia në kredite ECTS për çdo lëndë të bëhet e plotëpjestueshme me bazë 3 për arsye të lehtësirave në rastet e mobilitetit të studentëve dhe njohjes së lëndëve.*
- 5) *Rekomandohet të rishikohet procesi i transferimit të studentëve nga master profesional në master shkencor pasi masteri profesional mund të përdoret si tampolinë në programin Master i Shkencave duke shmangur kriterin e mesatares.*
- 6) *Rekomandohet vemendje më e madhe në mbajtjen dhe dokumentimin e notave në hard copy dhe përditësimin të tyre në regjistrin e notave.*



- 7) Rekomandohet vëmendje më e madhe në respektimin e afateve për dorëzimin e dokumentave, sidomos dokumenti i njohjes së gjuhës së huaj (angleze) pasi mësimi zhvillohet në gjuhën angleze pranë Universitetit EPOKA;
- 8) Rekomandohet përmirësim i formatit të diplomës duke hequr elementë si "partially fulfilled" nga kapaku i diplomës, dhe i procesit të diplomimit duke shtuar planin e diplomimit dhe kontrollet e detyrueshme;
- 9) Të shënohet literatura në Syllabuset e lëndëve

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof Ass. Florim Grajçevci

Phd. Egla Luca

